

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIV - Nr. 7736 E mërkurë 12 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Sot, më 12 dhjetor, Partia Demokratike e Shqipërisë mbush 28 vjet jetë dhe veprimtari politike, qeverisëse dhe opozitare. Kjo rrugë është e mbushur ...
Vijon në faqen 20

Nga XHEVAT MUSTAFA
PD-ja e sotme, ose e keqja jonë më e vogël...


Opinion *i* **Ditës**
Cila është e vërteta e kësaj kohe? E Cardhmja është ngritur në revoltë kundër të tashmes së shëmtuar. I.Pse dje kryeministri shqiptar u tregoi shqiptarëve ...
Vijon në faqen 21

Nga SPARTAK NGJELA
Korrupsioni shqiptar po dridhet nga studentët

Gjikhuri: Do nxjerrim përgjegjësit
Unaza, skandali me tenderin 18 milionë euro, SHBA konfirmon: Dokumentacion fals

“Zëri i Amerikës”: Ka dyshime se pas firmës “DH Albania” qëndron Bashkim Ulaj
Autoritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë vërtetuar zyrtarisht se një pjesë e dokumentacionit të kompanisë “Dunwell Haberman”, të paraqitura në garën për ndërtimin e Unazës së Re janë të falsifikuara. Në një dalje për mediat gjatë ditës së djeshme, ministri Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjikhuri ka bërë të ditur ...
Në faqen 6

MIJERA NE SHESH/ TE RINJTE: NUK TERHIQEMI PA U PLOTESUAR 8 KERKESAT STUDENTET PROTESTOJNE PERPARA KRYEMINISTRISE

Edi Rama: Kujdes me ultimatumet, të ulemi në parlament dhe të dialogojmë.
Protesta shpërthen edhe në rrethe, në Tiranë bashkohen gjimnazistët




(Në foto) Studentë duke protestuar përpara Kryeministritë

PROTESTA E 20 DHJETORIT
Dha dy intervista në “GSH”, pushohet nga puna në QSUT infirmieri Elson Jaçaj
Në faqen 7

ELBASAN
Prokuroria i sekuestron 39 makina të arrestuarit
Në faqen 8

KULTURE
Viktor Zhusti prezanton festivalin në RTSH, nga Italia vjen Ermal Meta
Në faqen 19

FLET KENGETARJA
Khoi Kallaverja: Në “Kënga Magjike” u vu re kush ishte “big” dhe kush jo
Suplement

HAKMARRJA

Akuzohet për vrasjen e grekes, shqiptari rrihet barbarisht në qeli
Në faqen 9

Lista e re/ Publikohen familjet që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit
Emrat, të përndjekurit që marrin kompensimin
Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 1400 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë më pas paratë. Lista është bërë publike dje nga Ministria e Financave. Behet fjalë për përfitues të kategorisë



jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të kështit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërblimin. Të gjithë ...
Në faqen 10-12

NGËRÇI FTESA

Kreu i qeverisë u shpreh parimisht dakord me 8 kërkesat e studentëve

Rama: Kujdes me ultimatumet, ulemi në parlament dhe dialogojmë

"Ariun se keni në qeveri po brenda e rrotull jush"

Kryeministri Edi Rama nuk ka arritur as dje që t'i bindë studentët që të dialogojnë për të zgjidhur kërkesat e tyre. Për këtë arsye ai ka zgjedhur sërish komunikimin nëpërmjet rrjeteve sociale për t'i bërë të ditur protestuesve se është gati të dialogojë me ta për të zgjidhur jo vetëm kërkesat e tyre, por edhe më shumë se atë. Por për të arritur këto ai ka theksuar dje se është e domosdoshme që të vendosen urat e komunikimit. "Të dashur protestues, kjo s'është një lojë forçe, as një lojë kungullesh-kash dhe as një lojë e ka kush e ka. Vazhdojeni protestën sa të doni, po ngrini urën e komunikimit me qeverinë. Unë ju pres në çdo orë që të doni dhe jam gati të punoj me ju, jo për t'i dhënë përgjigje pozitive 8 pikave po e po, por për ta kthyer këtë moment, në çeljen e një faze të re transformimesh për universitetin", shkroi Rama dje në 'Facebook'. Ai ka shkruar edhe më tej duke u shprehur i gatshëm që për të mundësuar dialogun të hapte edhe dyert e parlamentit, ku një përfaqësi e zgjeruar prej 140 studentësh të mund të bisedonin me të për t'i dhënë zgjidhje kërkesave të tyre. Ai madje në mesazhin e tij bëri të ditur se ishte gati që t'i ofronte studentëve më shumë se ata kërkojnë në kërkesat e tyre. "Do të ishte hera e parë në historinë e protestave në botë, që protestuesit kërkojnë nga qeveria plotësimin e disa kërkesave dhe s'duan të ulen në tryezë me qeverinë që u thotë hajdeni t'i plotësojmë! (Mbase "tryeza e qeverisë" është një term që e kufizon imagjinatën, po fare mirë mund të takohemi në sallën e parlamentit në sytë e gjithë popullit shqiptar. Ju 140 plus tërë karriget e ministrave me 8 pikat tuaja dhe unë përballë jush, me 8+ pikat e mia:)", shprehej Rama në mesazhin e tij. Ndërsa bëri të ditur se ai ishte dakord në parim me kërkesat e tyre, i bëri të ditur se gjith-



Kryeministri Edi Rama



IRONIA
"Eh Artist si e katandise opozitën! Të rinjtë e PD maskohen si studentë se ndryshe i përzënë; dega e Fierit zë rrugën me jelekë të verdhë sikur i merr porosinë nga Parisi; Bashkia e Kukësit shfaqet si grup biznesmenësh të vegjël që duan dyqan pa kasë; ndërsa ti vetë të Astir Boja,"-shkruan ai.

Strazimiri-Ramës: Ki frikë studentët, jo 'koburen' time

Kryeministri Edi Rama dhe deputeti demokrat, Gent Strazimiri janë përfshirë dje në një debat në distancë, ku mes tyre nuk kanë munguar ironitë. Nëpërmjet një komenti në 'Facebook', Rama ka sulmuar Strazimirin, pasi sipas tij ai ka kërkuar arrestimin e studentëve që kundërshtojnë militantët e PD-së. "Interesant! Kadri Strazimiri (ai i kobures tek lodrat e liqenit) kërkon arrestimin e studentëve që s'duan militantët e PD në protestë, e u adreson fyerje lumë pse përzënë "të vobektit" që u çon Kadri Kanza për tarifata e shkencës. Qimet i kanë lënë po zakoni u del veç me shpirtin", shkroi Rama. I menjëhershëm ka qenë reagimi i Strazimirit, i cili e paralajmëroi Ramën që të ketë frikë nga fuqia e studentëve dhe jo e kobures së tij. "Me PD mbase nuk janë të gjithë, por e sigurt është se të gjithë janë kundër teje, "pa dallim feje, krahine e ideje"! Janë të vjedhurit prej teje, të mashtruarit prej teje, të zbuarit nga Atheu prej teje, të përbuzurit prej teje, të tallurit prej teje! Ata ki frikë! Ata e jo "koburen" time", shkroi Strazimiri.

PROTESTA



DIALOGU

"Mbase "tryeza e qeverisë" është një term që e kufizon imagjinatën, po fare mirë mund të takohemi në sallën e parlamentit në sytë e gjithë popullit shqiptar. Ju 140 plus tërë karriget e ministrave me 8 pikat tuaja dhe unë përballë jush, me 8+ pikat e mia:)", shkroi Rama dje në 'Facebook'.



PËRÇARJA

"Ju mbytnë me presionin kundër dialogut se do ju përçajja unë, po tani kush ju përçau?! Mos e vrisni mendjen, unë jam me studentët jo me maskat e LSI-PD dhe s'ju lë në baltë. Jo ato pikat, po shumë më tepër se atë do bëjmë së bashku. Me të nisur Dialogun, s'ndalimi më për Universitetin"



Djali i Azem Hajdarit në protestë: Jemi gati të përballemi fizikisht

Protestës së studentëve, i është bashkuar dje edhe djali i vogël i liderit të dhjetorit, Azem Hajdarit. Në një prononcim për News 24, ai ka shprehur mbështetjen për protestën studentore, teksa është shprehur se ka ardhur koha të vendosin për veten, dhe se ata janë gati të konfrontohen dhe fizikisht për të mbrojtur të drejtat e tyre. "Ka ardhur momenti mes të qenit gozdhë apo çekiçi, ne duhet të jemi çekiçi i ndërtimit të ardhmes tonë. Në kupitimin përplasem me mish dhe me shpirt për të drejtat tona, njerëzit duhet të zgjedhin ose të shtypen. Këto trima po tregojnë se vërtet do jenë çekiçi i të ardhmes së tyre. Të gjithë këto të rinj që janë këtu do jenë në



profesione që do të kenë ndikim në të ardhmen tonë, apo të fëmijëve", tha Azem Hajdari, që mban emrin e të atit të tij.

Ai, gjithashtu, qartësoi se është bashkuar atyre vetëm si student dhe jo si përfaqësues partiak. "Njerëzit nuk e kanë vlerën me PD apo PS.

sesi ata që kishin dalë në shesh nuk ishin as 1/10 e studentëve të të gjithë Shqipërisë. "Ju jeni 10 mijë, studentët në Shqipëri janë 140 mijë. Ju flisni dhe s'doni të dëgjoni, unë i dëgjoj të gjithë dhe dua të flas edhe me ju. Ju keni 1 pikë pastaj bëhen 4 pika dhe më pas shkojnë 8 pika, ndërsa unë kam më shumë se 8 pika. Në

parim jam dakord me pikat tuaja, por secila prej tyre duhet zëbërthyer dhe kthyer në një politikë financimi, investimi apo administrimi. Të kjo nuk bëhet si gjëgjëzë në distancë, po si produkt i punës së përbashkët me laps e me letër", shkroi Rama. Ai, gjithashtu, i përcolli dhe një këshillë tjetër studentëve të heqin dorë nga

Babai im ka qenë student para se të ishte politikan, ndaj dhe unë vij si shok i këtyre të rinjve, që të jemi arkitektë të së ardhmes sonë", u shpreh ai. Dje pasdite skadoi afati i pritjes së plotësimit të kërkesave të studentëve. Edhe pse mes shumë debatesh mes tyre, studentët vendosën ta përshkallëzojnë protestën e tyre deri në mosbindje, teksa një pjesë bllokoi rrethrotullimin e "Zogut të Zi", një pjesë qëndroi përballë Ministrisë së Arsimit dhe një pjesë tjetër iu drejtua kryeministrit. Midis studentëve ka shumë konfuzion, dhe akoma nuk kanë marrë një vendim përfundimtar se si do vijojë protesta, ndërsa dje në mbrëmje u vu re një lloj përçarje e tyre.

ultimatumet dhe të ulen në tryezën e bisedimeve. "Kujdes nga kushdo ju mëson t'u jepni ultimatumet atyre që ju shtrijnë dorën e bashkëpunimit, sepse ju mëson si të bëheni humbës në jetë! Ndërsa kush kujton se një qeveri mund të kuptojë gjuhën e ultimatumëve, ndërkohë që vetë qeveria flet me gjuhën e dialogut, e ka gabim. Nëse ju keni lënë mësimin për ta bërë universitetin më të mirë, bujrum të ulemi dhe të fillojmë punën bashkërisht për këtë qëllim pa humbur kohë. Çfarë presim. Ju e dini vetë, po unë jam me ju jo me Ariun dhe Ariun se keni në qeveri po brenda rrotull jush", shprehej Rama në mesazhin e tij.



Voltiza Duro

Mëngjesin e djeshëm, mijëra studentët të universiteteve publike në vend, kanë tejmbushur rrugët e kryeqytetit si asnjëherë më parë. Me pankarta në duar e flamuj shqiptarë e amerikanë të rinjtë kanë marshuar nga fakultetet e tyre drejt Ministrisë së Arsimit paqësist e kanë ndaluar në fund para godinës së këtij institucioni duke thirrur në kor për plotësimin e 8 kërkesave të tyre kryesore. Studentët kanë refuzuar çfarëdo negociate me kryeministrin dhe nuk kanë lejuar politizimin e protestës duke larguar elementët partiakë. Në slogane "Kafshatë që s'kapërdihet është or vlla tarifa"; "Z. Kryeministër, na ktheni përgjigje deri në ora 16.00, se kemi kurs gjermanishte në orën 17.00"; "Shkurtoni kostot, jo ëndrrat"; "Koha për studentët"; "Në djall Gjermania, dua t'i shërbej vendit tim"; "Duam barazi"; "Nëse s'ka drejtësi për studentët, s'ka paqe për qeverinë" studentët i kanë dhënë ultimatum qeverisë deri në orën 16.00 të ditës së djeshme për të plotësuar zyrarisht kërkesat e tyre. Protesta ka nisur me këndimin e Himnit Kombëtar dhe më pas me parulla për plotësimin e kërkesave të tyre, kryesisht uljen e tarifave. Studentët e gjeologji-minierave kanë vendosur kaska të verdha, ndërsa studentët e arteve kanë marrë veglat muzikore. Studentëve iu janë bashkëngjitur edhe gjimnazistët e Tiranës.



"BLOKOJME RRUGËT"

"Vendimi se si do të vijojë protesta do të merret nga vetë studentët, nuk kemi përfaqësues për protestën tonë. Do i bllokojmë rrugët për sa kohë të plotësohen kërkesat tona. Çdo alternativë është e mundshme, çdo lloj gjëje mund të ndodhë", thotë njëri prej studentëve.



"DO TË RRIMË KËTU"

"Përderisa ne jemi këtu do i shkojmë deri në fund kësaj çështjeje. Do të qëndrojmë këtu derisa kryeministri të ulet me këmbë në tokë, të na përkrahë me ato të drejta që ne kërkojmë. Nëse ai nuk do të plotësojë minimumin e atyre që ne kërkojmë, do të qëndrojmë këtu", thotë studentit.

"Kryeministri të ulet me këmbë në tokë, të na përkrahë të drejtat minimale"

Protesta, studentët kalojnë natën para Kryeministrisë: Kemi marrë bukë me vete

"Nuk tërhiqemi deri në plotësimin e 8 kërkesave tona"



Protestat e djeshme të studentëve



8 KËRKESAT E STUDENTËVE

- 1-Rritja e buxhetit me 5 % e GDP me qëllim mundësimin e përgjysimit të tarifës së studimit për çdo nivel studimi, përmirësimin e mësimdhënies dhe infrastrukturës, Universitet/konvikt.
- 2-Transparencë me buxhetin nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe IAL-ve, publikimi i të gjitha shpenzimeve online.
- 3-Rritja nga 10 % në 50 % e peshës totale të votës së studentëve për të zgjedhur kandidatët për dekan, rektor dhe çdo fakultet të ketë një përfaqësues të studentëve në senatin akademik.
- 4-Rishikim i titujve akademikë dhe verifikimi i plagjiaturave të doktoraturave dhe teksteve mësimore.
- 5-Mbështetur në nenin 99 mbi Këshillat e Studentëve, Ligji i Arsimit të lartë, pika 2 kërkojmë që Bordi i Administrimit të IAL-ve të ketë numër të barabartë votash si nga MASR dhe IAL-të si dhe të shtohen një përfaqësues në këtë bord nga studentët.
- 6- Pajisja e të gjithë studentëve me Kartën e Studentit brenda vitit akademik 2018-2019 (të ndiqen nga bashkitë përkatëse)
- 7-Ndërtimi i një biblioteke me standarde Europiane dhe me libër universitar online, falas për studentët në gjuhën shqipe.
- 8-Vlerësim i performancës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor i pedagogut, publikim i tij, online dhe regjistrimi i leksioneve.

kërkesat tona. Çdo alternativë është e mundshme, çdo lloj gjëje mund të ndodhë", thotë njëri prej studentëve. Ndërkohë ata shprehen se kanë marrë edhe bukë me vete dhe do ta gdhijnë natën para Kryeministrisë dhe iu kanë bërë thirrje qytetarëve që të bashkohen me ta.

3

VATRAT

Pas bisedave para Ministrisë së Arsimit, protesta e studentëve u hap në tre vatra duke përshkallëzuar në ditën e tetë protestën. Përkatësisht, një pjesë e të rinjve bllokuan rrugët duke marshuar drejt "Zogut të Zi", në një kohë që disa të tjerë shkuan para Kryeministrisë, ndërsa disa qëndruan te Ministria e Arsimit.

THIRRJET

Ndërkohë, studentët që ndodheshin në "Zog të Zi", kanë vendosur t'i bashkohen studentëve që po protestojnë përpara Kryeministrisë. "Ejani mbildhuni këtu" dhe "Bashkohuni me ne" janë dy nga thirrjet e studentëve mbremjen e djeshme para godinës së kryeministrisë.

"Kemi marrë bukë me vete, na kanë sjellë e qytetarët, dhe ne do rrimë tërë natën këtu mbi libra, do lexojmë. Ju bëjmë thirrje të gjithë

qytetarëve që të na bashkohen në kauzën tonë"-tha një tjetër student. Studentët të ulur këmbëkryq e më të vendosur se kurrë thonë se nuk do të lëvizin nga sheshi pa u plotësuar kërkesat. "Ne kemi të njëjtën kauzë prandaj jemi këtu ku jemi. Përderisa kemi marrë këtë vendim, ne pranojmë që të bëhet diçka nga kryeministri Rama dhe minimumi të plotësohen ato 8 pikat bazë. Ne nuk kërkojmë shpikje, thjesht të drejtat e studentëve, asgjë më shumë. Përderisa ne jemi këtu do i shkojmë deri në fund kësaj çështjeje. Do të qëndrojmë këtu derisa kryeministri të ulet me këmbë në tokë, të na përkrahë me ato të drejta që ne kërkojmë. Nëse ai nuk do të plotësojë minimumin e atyre që ne kërkojmë, do të qëndrojmë këtu", thotë studentit. Mbrëmjen e djeshme, studentët që po protestonin para Ministrisë së Arsimit nisën aksionin për pastrimin e rrugës së Durrësit, ku zhvilluan edhe protestën më parë. Ata bënë me dije se protesta para godinës së MASR do të nisë sërish sot. Ndërkohë, studentët që ndodheshin në "Zog të Zi", kanë vendosur t'i bashkohen studentëve që po protestojnë përpara Kryeministrisë. Sa i takon studentëve që po protestojnë përpara Ministrisë së Arsimit, një grup i vogël prej tyre ka vendosur t'i bashkohet gjithashtu pjesës protestuese përpara Kryeministrisë. "Ejani mbildhuni këtu" dhe "Bashkohuni me ne" janë dy nga thirrjet e studentëve mbremjen e djeshme para godinës së kryeministrisë.

PROTESTAT BLLOKIMI

Protestë në 9 qytete të vendit, "jelekëverdhet" në rrugë kundër çmimit të naftës

Shembja, banorët e "Astirit" kërcënojnë kompanitë: Ju pret benzina

38 ditë në protestë, Basha takon banorët

Valentina Madani

Banorët e zonës së "Astirit" kanë hyrë në ditën e 38 të protestës kundër shembjes së banesave të tyre, që preken nga ndërtimi i Unazës së Madhe. Banorët u vendosën në të dyja anketat e rrugës pranë mbikalimit në këtë zonë, duke bllokuar qarkullimin e mjeteve. Në mbështetje të tyre ishin edhe deputetë të opozitës si dhe kryetari i PD-së, Lulzim Basha. "Gjithkush në burg, poshtë projekti", janë disa nga thirrjet në kor të protestuesve. Protesta e tyre hyn në ditën e 38-të, teksa banorët bllokuan rrugën duke ndaluar qarkullimin. Banorët ishin veshur me jelekë portokalli, duke marrë shkas nga protesta e zhvilluar në Francë. Ata u shprehën se nuk do të ndalin protestat deri kur qeveria të tërheqë vendimin për prishjen e banesave. Protesta tek Unaza e Re shënon ditën e 38, ndërsa banorët kundërshtojnë prishjen e banesave të tyre siç e parashikon plani për ndërtimin e aksit nga sheshi "Shqiponja", te mbikalimi pranë pallatit me shigjeta. Banorët bënë thirrje kundër qeverisë, teksa e kanë quajtur atë si qeveri hajdute dhe e krimi. Banorët kërcënuan edhe kompanitë zbatuese të projektit të Unazës së Madhe, duke u thënë që të mos guxojnë që të sjellin makinëritë për të shembur pronat e tyre, pasi i pret benzina. "Ju pret benzina. Ju bëjmë thirrje të mos tentoni të afroheni për të prekur pronën tonë", tha një banor. Ndërkohë, në kor ata kanë sfiduar kryeministrin Rama që të shkojë në zonën e prekur duke thënë "Hajde po ta mbajti", "Shtëpitë do t'i mbrojmë me gjak".

KRYEMINISTRI

Qytetarë të shumtë dolën dje në protesta në 9 qytete të Shqipërisë kundër qeverisjes së kryeministrin Edi Rama. Banorët bllokuan aksent kombëtare dhe dogjën gomat e makinave. Protesta u zhvil-



THIRRJA

Përmes një faqeje të hapur në 'FB' me thirrjen "Eja protesto për naftën!" janë ftuar të gjithë qytetarët shqiptarë të protestojnë mbi çmimin e naftës dhe cilësinë me të dobët në rajon.

Unaza e Re, Vasili: Të fillojnë arrestimet me Ramën dhe Gjithkushin

Qeveria shqiptare është detyruar të pranojë dje se kompania fituese e Unazës së Re është një falsifikatore, e konfirmuar nga zyrtarët nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një nga drejtuesit e LSI, Petrit Vasili, i bëri thirrje prokurorisë që të fillojë arrestimet duke filluar nga kryeministri. "Tenderat me konkurrencë me zero lekë, me kompani mashtruese dhe me rekorde të zeza dhe vjedhja kriminale është sheshit dhe e orkestruar nga qeveria. Asnjë justifikim, asnjë alibi, thjesht vjedhje kriminale. 30 milionë euro, mafiozët e qeverisë i vjedhin dhe kanë bërë gati edhe ku do




t'i çojnë deri në Amerikë. Hetimi i qeverisë fillon nga arrestimi i qeveritarëve dhe drejtorëve. Çdo sekondë që këta rrinë nëpër zyra fshihin dhe bëjnë pis provat e korrupsionit. Prokuroria të

shpëtojë veten, të veprojë shpejt dhe të nisë arrestimet nga ministri, Kryeministri e drejtorët. Kusarët e qeverisë në burg, kjo është më e pakta", deklaroi z.Vasili.

luan në Fier, Durrës, Vlorë dhe Elbasan. Në Shkodër raportohet se banorët bllokuan rrugët dhe dogjën gomat e makinave në shenjë proteste. Nga kjo situatë u krijua kaos si pasojë e trafikut, duke bllokuar aksent rrugore. Banorët e veshur me jelekë të gjelbër kanë bllokuar rrugën në shenjë proteste. Qytetarët e Fierit

kërkojnë uljen e taksave, pasi kushtet ekonomike të familjeve të tyre po vështirësohen çdo ditë e më shumë. Sipas tyre, taksat e larta rrezikojnë mbylljen e biznesit të vogël në Fier, burimi kryesor ekonomik dhe punësimi për shumë prej familjeve protestuese. Edhe në Durrës banorët dolën në rrugë dhe kërkojnë ulje të

taksave. Protestuesit bllokuan rrugën nacionale Durrës-Tiranë. Dhjetëra banorë në Durrës kanë bllokuar për disa minuta autostradën që lidh këtë qytet me kryeqytetin. Protesta është zhvilluar në zonën e Sukthit dhe kryesisht banorët kanë protestuar kundër rritjes së çmimit të naftës. Edhe në Vlorë



28-vjetori i PD-së

BLLOKIMI

Qytetarë të shumtë dolën dje në protesta në 9 qytete të Shqipërisë kundër qeverisjes së kryeministrin Edi Rama. Banorët bllokuan aksent kombëtare dhe dogjën gomat e makinave. Protesta u zhvillua në Fier, Durrës, Vlorë dhe Elbasan. Në Shkodër raportohet se banorët bllokuan rrugët dhe dogjën gomat e makinave në shenjë proteste.



PD, Shehaj: U kapën duke vjedhur, zgjedhin që të duken si idiotë

Deputeti i PD-së, Agron Shehaj ngriti dje pikëpyetje lidhur me faktin që ministri Gjithkushin dhe kreu i ARRSH-së, Afrim Qendro kanë negociuar e nënshkruar një kontratë 18 milionë euro me një 26-vjeçar dhe se nuk kanë dyshuar asgjë. "Po çfarë ministrie dhe institucione janë këto? Institucione shtetërore apo kioska rrugë? Në të vërtetë, Gjithkushin dhe dy drejtorët e mëdhenj të ARRSH-së dhe OST-së janë thjesht shërbëtorët e përdorur nga Edi Rama për të vjedhur dhe pastruar paratë 30 milionë euro. Por tani që u kapën duke vjedhur, ata kanë zgjedhur që më mirë të duken idiotë në publik, se sa të dalin ashtu siç janë: hajdutë të rëndomtë e të paskrupuj", shprehet z.Shehaj. Ministri i Infrastrukturës dhe Energjetikës, Damian Gjithkushin konfirmoi pezullimin e fitueses së lotit të parë të projektit të Unazës së Re dhe të kontratës me OST, ndërsa buxheti i shtetit nuk ka humbur para nga zgjidhja e marrëveshjeve.

qytetarët kanë bllokuar hyrjen e autostradës Vlorë-Fier. Bllokimi i aksent rrugore ka ndodhur dhe në Bradashesh. Qytetarët kanë bërë thirrje për ulje të çmimit të naftës dhe energjisë elektrike. Mësohet se në Elbasan janë bashkuar edhe studentët që protestuan paraditen e djeshme në Tiranë. Ndërkohë, bllokime

rrugësh ka pasur edhe në aksent tjera nacionale në vend, si ai Fier-Vlorë, Korçë-Pogradec apo Rruga e Kombit në zonën e Milotit. Në Korçë dhe Devoll, përveç rritjes së çmimit të karburantit, fermerët kanë hedhur prdhimet bujqësore në tokë, si shenjë proteste për mosmarrëveshjet dhe pro-dhimet të tyre.



28-vjetori i themelimit, kreu i PD: Kjo parti i ka rrënjët te protesta popullore

Basha: Qeveria po e mban pushtetin si një bankë private

"Studentët po lajmërojnë ndryshime në Shqipëri"

Valentina Madani

PD në ditëlindjen e 28 ka sfidë të saj rikthimin e besimit të njerëzve. Për Lulzim Bashën, kreu e Partisë Demokratike, protesta e studentëve është një thirrje për një dhjetor të dytë. Në ditën e përvjetorit të themelimit të PD-së, ai u shpreh se gjithçka iu dedikohet studentëve. Në 28-vjetorin e themelimit të Partisë Demokratike, Basha e cilësoi bekim për vendin protestën e studentëve. Lideri i PD-së, në një takim me themelues dhe intelektualë të PD në selinë blu deklaroi se në dhjetor të 1990-ës studentët shqiptarë vranë frikën, ndërsa e njëjta situatë sipas tij është edhe sot, referuar protestës së studentëve para Ministrisë së Arsimit prej tetë ditësh. "Partia Demokratike u themelua në valën e protestave të studentëve, që sollën pluralizmin në Shqipëri. Kjo është një ditë e shënuar për ne si demokratë, por edhe për të gjithë shqiptarët. Dita e themelimit të PD-së i ka rrënjët e veta në protestat e studentëve dhe mbarëpopullore. Kohët nuk janë vetëm të kujtesës, këto minuta, tani ndërsa flasim, janë orë të revoltës popullore, sepse studentët shqiptarë janë në rezistencë dhe sakrificë për liritë dhe të drejtat, duke thirrur një dhjetor të dytë", u shpreh Basha. Fjalimi nga selia e PD-së, në shënimin e përvjetorit të 28 të themelimit të partisë, u mbajt nga kryetari i PD-së, vetëm pak pas afatit të ultimatimit të studentëve protestues. "I gjithë respekti është për ta, nderimi është për ta - tha z.Basha. - Gjithçka bëhet për të mbrojtur lirinë dhe demokracinë. Kjo e sotmja nuk është një ditë festimi. Jam i vetëdijshëm se ndërsa ju drejtohem juve, e përmes kamerave edhe të gjithë qytetarëve shqiptarë, shprej që një pjesë e ekranit të vazhdojë të shfaqë dhjetorin e dytë, që shpirti rinor shqiptar ka sjellë në sheshet e qyteteve tona, si këtu në Tiranë para Ministrisë së Arsimit, Kryeministrit dhe në 'Zogun e Zi', por edhe në rrugët e qyteteve të tjera të Shqipërisë", u shpreh kreu i PD-së. Basha u bëri të qartë atyre që kanë lindur 20 vitet



NDRYSHIMI

Kreu i PD-së reagoi dje lidhur me protestën masive të studentëve. Basha shkruan se ndryshimet në arsimin e lartë fillojnë me shfaqjen e ligjit të arsimit dhe dyfishimit e buxhetit. Basha akuzon kryeministrin Edi Rama që të mos investojë para në projekte fasadë.

Dhjetori i dytë, Patozi: Uroj të përfundojë me një forcë të re politike

Si një prej studentëve të dhjetorit 1990, ish-deputeti Astrit Patozi e mbështet protestën e ditëve të fundit të studentëve. Në studion e "Top Talk", ai shprehu dëshirën e tij që kjo protestë të përfundojë me krijimin e një force të re politike. "Shqipëria është në një situatë anormale. Nëse protesta do të kish të bënte vetëm me një ligj të caktuar, pasi qeveria do e kishte gjetur një zgjidhje. Ata janë në unison se nuk e konsiderojnë as qeverinë e tyre dhe as opozitën e tyre. Uroj që kjo protestë të përfundojë me një forcë



politike dhe me kërkesa politike. Kemi nevojë për një riformatim të demokracisë. Nuk jam për rrugë revolucionare. Edhe studentët më duken se janë të këtij qëndrimi, pasi janë paqësorë", u

shpreh Patozi. Më tej ai shtoi se edhe nëse forca e re politike nuk do të krijohet nga studentët, do të jetë shoqëria shqiptare ajo që do ta nxjerrë një forcë të re politike.


AKUZA

"Ortakëria e babëzitur ka dobësuar mekanizmat e kontrollit të qeverisë. Pushteti ka sjellë kriminelët në majë të pushtetit, viktimat janë shqiptarët. Sfidat janë më të madhe, vendimet e PD është kthimi i besimit të njerëzve. Me këtë barrë të rëndë kemi mbledhur sot këtu. Të rinjtë sollën pluralizmin dhe një ndryshim i tillë po lajmërohet sot në Shqipëri", tha z.Basha.



BERISHA

Ish-kryeministri Sali Berisha përshëndeti revoltën e fuqishme të studentëve në të gjithë vendin, të cilën e ka konsideruar një "revolucion". Në një mesazh të publikuar në rrjetet sociale, Berisha shprehet: "Lumenj revolte dhe pakënaqësie ndaj kaktiviteteve në grahamet e fundit të mbështetje të studentëve vërshojnë sot në mbarë Shqipërinë. Nderim studentëve dhe revolucionit të tyre për drejtësi sociale".



LSI, Rama: Kryeministri hipokrit, frikacak!

Hipokrit, frikacak", kështu e cilësoi dje kryeministrin, deputeti i LSI, Luan Rama, pas tentativave plot kthesa që po bëjnë këto ditë për të shuar protestën masive të të rinjve në të gjithë Shqipërinë. "Studentët kanë tri vite që protestojnë, po askush nuk i dëgjoi, askush nuk i pyeti! - shprehet Rama. - Dhe kur u mbledhën sërish disa ditë më parë, kryeministri i quajti ngelës, u tall dhe qeshi me ta! Ndërsa sot 'ngelësit' i fton për dialog, u kërkon urë komunikimi me qeverinë e tij! Hipokrit dhe frikacak!"

KONTRATA FALSIFIKIMI

Ministria zgjidh kontratën me "DH Albania", Gjikhuri: Do nxjerrim përgjegjësit

Skandali me 18 mln euro tek Unaza e Re, SHBA konfirmojnë falsifikimin

"Të tria lotet e Unazës do të shkojnë në hetim"

Autoritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë vërtetuar zyrtarisht se një pjesë e dokumentacionit të kompanisë "Dunwell Haberman", të paraqitura në garën për ndërtimin e Unazës së Re janë të falsifikuara. Në një dalje për mediat gjatë ditës së djeshme, ministri Infrastruktural dhe Energjisë, Damian Gjikhuri ka bërë të ditur se institucionet amerikane kanë konfirmuar dyshimin e ngritur nga mediat shqiptare se dega e saj "DH Albania" ka falsifikuar dokumentet, ndërsa ka mundur të sigurojë kontratën për ndërtimin e lotit të parë të Unazës së Madhe në segmentin nga sheshi "Shqiponja" deri te lumi Lana, me një vlerë totale prej afro 18 milionë euro. "Kam komunikuar për të marrë informacione nga autoritetet amerikane. Nga përgjigjet e ardhura dje thuhet se një pjesë e paraqitur nga "DH Albania" nuk është e saktë, por e falsifikuar", tha ministri i Infrastruktural, Damian Gjikhuri. Menjëherë pas marrjes së kësaj përgjigjeje, ministri Gjikhuri bëri të ditur se ARRSH ka zgjidhur përfundimisht kontratën me "DH Albania".

"Pas marrjes së këtij konfirmimi nga SHBA, ARRSH ka zgjidhur menjëherë kontratën në fjalë dhe do të fillojë procedurat për sekuestrimin e garancisë financiare në vlerën 10% të kontratës. Materialet e ardhura nga SHBA do t'i referohen prokurorisë, e cila tashmë ka hapur një hetim për falsifikimin e dokumenteve zyrtare nga kompania "DH Albania", tha Gjikhuri. Por, kjo është vetëm njëra pjesë e kësaj historie, pasi "DH Albania" rezultoi që thuhet në të njëjtat kushte të ketë mashtruar institucionin që drejton Gjikhuri edhe për një kontratë tjetër me OST-në dhe që kap sërish një vlerë të konsiderueshme prej 11 milionë euro të tjera. Gjikhuri theksoi se edhe për këtë rast, OST është urdhëruar që të zgjidhë kontratën me "DH Albania". "Të njëjten praktikë ka ndjekur edhe Operatori i Sistemit të Transmetimit", u shpreh Gjikhuri, ndërsa siguroi se deri më tani nuk rezultoi të jetë shkaktuar asnjë dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Duke shmangur përgjegjësinë e tij dhe të institucionit që ai drejton mbi këtë aferë, Gjikhuri bëri të ditur se falsifikimi i të gjitha dokumenteve rezultoi të jetë kryer jashtë territorit të Shqipërisë dhe se hapat e procedurës e ndjekura nga ARRSH kanë qenë konform ligjit. "Legjislacioni në fuqi



Ministri i Infrastruktural, Damian Gjikhuri

HETIMET

Prokuroria e Tiranës ka bërë të ditur se ka nisur hetimet edhe për skandalin tjetër të kompanisë "DH Albania", atë të linjës 220 kilovolt Burrel-Peshkopi me vlerë 12 milionë euro. Burime të prokurorisë thanë se dy dosjet e Unazës së Madhe dhe ajo e OST-së janë bashkuar.

nuk kërkon verifikimin e informacionit të ofertesve", - u shpreh ministri. Ndërkohë që Gjikhuri bëri të ditur se përveç lotit të parë, do të hetohen edhe kontratat për dy lotet e tjera të Unazës së Madhe. "Të tria lotet do të shkojnë në hetim dhe nga kjo do të dalin të vërtetat", tha Gjikhuri. Ai

ka theksuar se përgjegjësia direkte bie mbi ata të cilët kanë marrë përsipër të bëjnë këtë falsifikim, ndërsa ka kërkuar nga prokuroria ta hetojë këtë çështje deri në fund, për të zbuluar kush janë autorët e vërtetë të këtij falsifikimi dhe ata që fshihen prapa tij. "Patjetër, edhe unë si ministër dhe drejtues-

it e institucioneve të prekurra nga ky falsifikim do të reflektojmë duke nxjerrë edhe përgjegjësitë tona administrative përkatese. Përsa u përket akuzave se prapa kësaj shoqërie fshihet Damian Gjikhuri, po deklaroj me përgjegjësinë time të plotë si ministër, si deputet dhe si qytetar se nuk kam

VOA: Dyshime se pas firmës "DH Albania" fshihet biznesmeni Ulaj

Në Shqipëri janë shtuar pikëpyetje rreth firmës së regjistruar në Delaware të SHBA, "Dunwell Haberman", e cila përmes falsifikimit të dokumenteve të regjistrimit si kompani kishte arritur të siguronte dy kontrata me vlerë prej rreth 30 milionë eurosh nga qeveria shqiptare. Firma kryente biznes me emrin "DH Albania" dhe në regjistrat kombehtarë si përfaqësues i saj figuron 26-vjeçari Avdjol Dobi. Kur këto fakte u bënë publike, lindën dyshimet se si një firmë pothuajse anonime mundi që me kaq lehtësi dhe falsifikime të siguronte kontrata të kësaj natyre. Për të fituar një kontratë të tillë, firma fituese duhet të depoziton-



te një shumë prej 10 për qind të vlerës së investimit, ndërsa zoti Dobi nuk dihet të ketë pasur biznes për të bërë këtë depozitë. Ndërkohë, ka dyshime të forta se pas kompanisë "DH Albania" fshihet biznesmeni i njohur Bashkim Ulaj. Para një muaji, përfaqësuesi i firmës e ka transferuar adresën e tij në kullën "ABA Business Center", në pronësi të zotit Ulaj.

"Zëri i Amerikës" ka mësuar se zoti Dobi ka lidhur familjare me biznesmenin Ulaj. "Zëri i Amerikës" u lidh me zotin Ulaj për t'i kërkuar konfirmim për këto informacione, por përpjekjet rezultuan pa sukses. I pyetur në telefon, Ulaj nuk pranoi të përgjigjet, duke thënë se ishte i zënë. Bilanci i kompanisë "Dunwell Haberman", i dorëzuar në Qendrën e Regjistrimit të Biznesve rezultoi të jetë përkthyer nga zonja Shenda Kruga, e cila nuk figuron në listën e përkthyesve zyrtarë, të miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Ajo rezultoi në rrjetet sociale si specialiste pranë kompanisë "Gener" 2 të zotit Ulaj.

pasur asnjë lidhje dhe as dijeni rreth këtij aktiviteti kriminal të kryer nga kjo kompani", u shpreh Gjikhuri. Ndërkohë që VOA e konsideronte dje të habitshme lehtësinë me të cilën kjo kompani arrin të sigurojë dy kontrata të majme, me një vlerë totale prej afër 30 milionë eurosh. Dhe të gjitha

këto, vetëm me anë të një 26-vjeçari, Avdjol Dobi, përfaqësuesi i saj në Shqipëri. Me tej, VOA thekson se është "po kaq e habitshme, se si një sipërmarrje e tillë e mbështetur në falsifikime të mund të realizohet pa pasur asnjë garanci se të paktën, askush nuk do të gërmonte mbi aktivitetin e saj real".

"DH Albania" fitoi me garë fiktive kontratën 12 mln euro me OST-në

Skema e përdorur në fitimin e tenderit me vlerë 18 milionë euro për lotin e parë të Unazës së Madhe, është përdorur nga "DH Albania" edhe një tander tjetër sërish me një vlerë të konsiderueshme. Bëhet fjalë për një kontratë me vlerë 12 milionë euro për ndërtimin e linjës elektrike Burrel-Peshkopi. Dokumentet zyrtare të publikuara nga Agjencia e Prokurimeve Publike tregojnë se edhe në rastin e këtij tenderi, gara ka qenë thuhet fiktive, me

vetëm një ofertë të vlefshme. "Top-Channel" bën të ditur se tenderi për linjën Burrel-Peshkopi është zhvilluar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në datën 6 shtator të këtij viti dhe fondi limit i përcaktuar ka qenë 1 miliard e 206 milionë lekë. Në garë kanë marrë pjesë dy kompani "DH Albania", pra dega në Shqipëri kompanisë guaskë "Dunwell Haberman", si dhe një kompani tjetër shqiptare me emrin "Argus Power shpk". Por pjesëmarrja e kompanisë së dytë ka qenë fiktive dhe për të ligjëruar garën

për kompaninë "DH Albania". Kjo, pasi kompania "Argus" nuk ka paraqitur ofertë financiare, duke qenë automatikisht e skualifikuar. Rrethimisht në tender ka pasur vetëm një ofertë të vlefshme, ajo e "DH Albania" dhe çmimi i ofruar nga kjo kompani ka qenë saktësisht 1 miliardë e 206 milionë lekë, aq sa fondi limit i përcaktuar. Duke përfshirë edhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, vlera totale e kontratës shkon në 1 miliard e 447 milionë lekë ose rreth 12 milionë euro. Sipas dokumenteve, tenderi rezultoi



një procedurë me efektivitet prokurimi zero, ku për shkak të mungesës së garës, kontrata është fituar me vlerë sa 100 për qind e fondit limit, duke mos u kursyer taksapaguesve asnjë lekë. Por, OST sërish ka vazhduar me procedurën duke e shpal-


lur fituese kompaninë "DH Albania". Skema është identike me tenderin e Unazës së Madhe, vetëm se këtë herë institucionin kontraktues nuk ishte Autoriteti Rrugor, por Operatori i Sistemit të Transmetimit, pjesë e së njëjtës ministri.

Jaçaj: Këta e hanë turpin me bukë, protesta do bëhet

Pushohet nga puna infermieri pas dy intervistave të dhëna për "Gazeta Shqiptare"

Ditën e djeshme, infermieri i QSUT-së, Elson Jaçaj është pushuar nga puna pas dy intervistave të dhëna për "Gazetën Shqiptare". Dy ditë më parë, në një intervistë për "GSH", Jaçaj i cili është edhe kreu i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë deklaroi se në 20 dhjetor të këtij viti, bluzat e bardha do të protestojnë për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe kushte më të mira në vendin e punës. "Sot (dje) rreth orës 14.00 më komunikuan në telefon se duhet të paraqitesha pranë Drejtorisë së QSUT-së. Pasi shkova mora letrën në të cilën paraqitej shkarkimi im nga puna. Letra është firmosur nga drejtori i QSUT, Enkelejd Joti, por, në fakt, çdo masë dhe çdo vendim e merr drejtoresha e burimeve nëpunësive të këtij institucioni me detyrën infermier pavioni pranë Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent, i ndërpriten marrëdhëniet kontraktuale me QSU "Nënë Tereza" për shkelje të kushteve të Kontratës së Punës Individuale. Punonjësi i QSUT-së, nuk duhet të bëjë në publik komente të papërshtatshme si deklarata apo opinione personale, sulme kundër administratës apo punonjësve të tjerë të institucionit. Sjellje të tilla mund të konsiderohen gjithësi si cenim i rregullave të etikës nëse vlerësohet se dikojnë në besimin e publikut dhe reputacionin e institucionit", theksohet në vendimin e marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të QSUT-së.

DESHMIA
"Sot (dje) rreth orës 14.00 më komunikuan në telefon se duhet të paraqitesha pranë Drejtorisë së QSUT-së. Pasi shkova mora letrën në të cilën paraqitej shkarkimi im nga puna. Letra është firmosur nga drejtori i QSUT, Enkelejd Joti, por, në fakt, çdo masë dhe çdo vendim e merr drejtoresha e burimeve njerëzore, Suela Zina", - tha infermieri për "Gazeta Shqiptare".



VENDIMI I QSUT
Elson Jaçaj më tej zbardh edhe vendimin e marrë nga drejtoresha e burimeve njerëzore të këtij institucioni. "Z. Elson Ismail Jaçaj, punon-

jës i këtij institucioni me detyrën infermier pavioni pranë Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent, i ndërpriten marrëdhëniet kontraktuale me QSU "Nënë Tereza" për shkelje të kushteve të Kontratës së Punës Individuale. Punonjësi i QSUT-së, nuk

duhet të bëjë në publik komente të papërshtatshme si deklarata apo opinione personale, sulme kundër administratës apo punonjësve të tjerë të institucionit. Sjellje të tilla mund të konsiderohen gjithësi si cenim i rregullave të etikës nëse vlerësohet se dikojnë në besimin e

publikut dhe reputacionin e institucionit", theksohet në vendimin e marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të QSUT-së.

PROTESTA
Pavarësisht shkarkimit nga puna, infermieri thekson se nuk do të heqë dorë nga mbrojtja e të drejtave të infermierëve. Ai thekson se protesta do të bëhet në 20 dhjetor të këtij viti. "E kanë ngrënë turpin me bukë, s'kanë më cipë; por duroni dhe pak ta shikoni. Protesta e bluzave të bardha do të bëhet, patjetër që po", thekson Jaçaj për "Gazeta Shqiptare". / **vo.du.**

Ministria e Shëndetësisë: Afati i fundit i konkurrencimit, dokumentacioni që nevojitet

Voltiza Duro

Nis aplikimi, vende vakante për infermierë e fizioterapistë në 12 qarqe

Gara edhe për teknikët e imazherisë, laboratorit e mamitë

Deri në datën 31 dhjetor të këtij viti, të gjithë punonjësit e licencuar të shkencave teknike mjekësore mund të aplikojnë në portalin "Infermierët për Shqipërinë" për vendet e lira të punës. "Gazeta Shqiptare" publikon sot vendet e lira në pozicionet infermier, teknik imazherie, mami, fizioterapist e teknik laboratorit në 12 qarqet e vendit. "Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale shpall konkursin e hapur për profesionistë të shkencave teknike mjekësore në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë. Afati për aplikim është deri me datë 31/12/2018. Aplikimi do të kryhet në platformën on-line "Infermier për Shqipërinë", thuhet në njoftimin e ministrisë. Në këtë të fundit bëhet me dije më tej se kjo shpallje bëhet me qëllim krijimin e listës së pritjes, sipas qarqeve për profilet për të cilat po përfundon lista e kandidatëve në pritje të një vendi pune. Fituesit që janë aktualisht në listë pritje do të vazhdojnë të punësohen sipas radhës deri në daljen e fituesve nga konkurrimi i radhës. Kandidatët që do të mbeten në listë pritje do të ripozicionohen sipas pikëve që kanë. Ata, gjithashtu, mund të futen në konkurrim për të ndryshuar pikët e tyre, në fund të konkurrencimit do ju njihen pikët që do kenë nga ky proces.



Foto ilustruese

laratë për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur udhëzimit nr. 493; d. Fotokopje e diplomave dhe lista e notave për çdo diplomë (e detyrueshme); e. Fotokopje e noterizuar e

lejes së ushtrimit të profesionit (e detyrueshme); f. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka); i. Fotokopje të noterizuara të dëshmisë/ve së njohjes së gjuhës/ve të huaja (nëse

Tabela me profilet e kërkua sipas Qarqeve:

Qarqet	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laboratorit
Shkodër	Infermier	Mami		Teknik Imazherie	Teknik laboratorit
Kukes	Infermier	Mami		Teknik imazherie	Teknik laboratorit
Lezhe	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik Imazherie	Teknik laboratorit
Dibër	Infermier	Mami		Teknik imazherie	Teknik laboratorit
Durrës	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laboratorit
Elbasan				Teknik imazherie	
Berat	Infermier				Teknik laboratorit
Korce	Infermier		Fizioterapist	Teknik Imazherie	Teknik Laboratorit
Tirana	Infermier				
Fier			Fizioterapist		Teknik laboratorit
Vlore	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	
Gjirokastr	Infermier	Mami		Teknik imazherie	

ka)-, thekson MSHMS. **VLERËSIMI**
Vlerësimi i kandidatit bëhet me dy faza: faza parë që është vlerësimi i dosjes deri në 30 pikë; faza e dytë që konsiston në testimin me

shkrim deri në 70 pikë. "Testi me shkrim përbëhet nga dy pjesë: Pjesa e parë përmban pyetje rreth akteve ligjore: -Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Sh-

qipërisë", i ndryshuar; -Ligji nr:9718, datë 19.4.2007 "Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë". Pjesa e dytë përmban pyetje bazë rreth profesionit. Vlerësimi i testit bëhet me sistemin e 70 pikëve", thekson ministria. Ndërkohë, duke filluar nga data 3 janar i 2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të shpallë në portalin "Infermier për Shqipërinë", listën paraprake të kandidatëve që kualifikohen për vazhdimin e procedurës së testimit me shkrim.

DOKUMENTACIONI
"Dokumentet e domosdoshëm për aplikim për profesionistë të shkencave mjekësore teknike: a. Curriculum vitae, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, të udhëzimit nr. 493; b. Raport mjeko-ligjor i tre muajve të fundit (në momentin e punësimit); c. Dek-

Njoftim për shitje me ankand
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k do të zhvillojë ankandin e pare të pasurisë të palës debitore Shqiptaria "General Polymeren Recycling Albania" sh.p.k. e përbërë nga:
- "ARE", Nr pasurie 3173, nr Z K Nr. 225, volumn nr.5, faqe 235, me sipërfaqe totale 7033 m2, me Koxhas, Durrës Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillfilltar në masen 163.615, 7 Euro.
- "ARE", Nr. n pasurie 314, nr Z K Nr. 225, volumn nr.1, faqe 212, me sipërfaqe totale 12.900 m2, me Koxhas, Durrës. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillfilltar në masen 300.105, 6 Euro.
- "ARE", Nr pasurie 313, Z K Nr. 225, volumn nr.1, faqe 219, me sipërfaqe totale 4.300 m2, me Koxhas, Durrës. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillfilltar në masen. 100.035, 2 Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 24.12.2018 prej orës 15:00 në selinë: Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontaktlo tel. 00355672082543 ose në faqen WEB www.powerjustice-at.com

Njoftim për shitje me ankand
Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në mesin 567.568 e vijues te K.P.L.C shpall ankandin e pare për pasurinë e palës debitore Sh"Strati Construcon" sh.p.k. K Strati dhe L Strati. Pasuria përbehet nga:
- "Are", Nr. pasurie 17222 ribotuar në drag dhe Durrës, Z K Nr. 1522, volumn 3, faqe 249, me sipërfaqe totale 1.000 m2, Ankandi fillon me çmimin fillfilltar në masen 3.200.000 lekë
- "Apartment", Nr pasurie 11648-1-19 në Kryemadhe Kavajë, Z K Nr. 2291, volumn 22, faqe 42, me sipërfaqe 33.19 m2, Ankandi fillon me çmimin fillfilltar në masen 1.520.000 lekë
- "Apartment", Nr pasurie 11648-1-20 në Kryemadhe Kavajë, Z K Nr. 2291, volumn 23, faqe 43, sipërfaqe 59.24 m2 dhe Ankandi fillon me çmimin fillfilltar në masen 2.720.000 lekë
Ankandi qendron i hapur 15 ditë dhe do të zhvillohet në datë 24.12.2018 në orën 15:00 në Bulevard "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Strati. Oportunitë dhjet të kërkesave dokumentacioni të kontaktë me tel. 00355 67 20 82 543 ose e-maili llir_dervishaj@yahoo.com u dhe WEB www.powerjustice-at.com

DURRËS - Policia Kufitare e Durrësit ka sekuestruar mbi 5 kg drogë në brendësi të një kamioni, ndërsa është arrestuar shoferi dhe është shpallur në kërkim një tjetër. Gjithashtu, blutë kanë prangosur 3 shtetas të huaj me dokumente false. Burime zyrtare nga dikasteri i Rendit dhe bënë me dije se gjatë kontrollit të ushtruar mbrëmjen e së hënës në vijën e dytë, në kabinën e një kamioni kanë gjetur të fshehur lëndë narkotike.



Kontrollet, kapen 3 shtetas të huaj me dokumente false

Sekuestrohet marijuanë në kamion, arrestohet shoferi dhe një tjetër shpallet në kërkim

Gjatë peshimit të kryer nga ana e specialistëve për hetimin e narkotikëve, lënda narkotike e llojit marijuanë ka rezultuar në peshën 5 kg e 300 gr. e cila është sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Ndërkaq, është arrestuar në flagrancë shtetasi T.H.,

31 vjeç, banues në Durrës (drejtuesi i kamionit), ndërsa është shpallur në kërkim shtetasi E.H.. Në ngarkim të shtetasve të mësipërm materiale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve"

në bashkëpunim. Gjithashtu, si rezultat i kontrolleve të dokumentacionit të udhëtarëve janë arrestuar në flagrancë tre shtetas të huaj me dokumente të dyshuara të falsifikuara, në tentativë për të kaluar kufirin drejt Italisë në

mënyrë të paligjshme, konkretisht: V.E., 30 vjeç, banues në Turqi; S.A., 43 vjeç, banues në Turqi dhe R.A., 32 vjeç, banuese në Filipine. Në ngarkim të shtetasve të mësipërm, materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprën penale "Falsifikimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave". Policia Kufitare vijon punën për të goditur paligjshmërinë në kufi duke forcur kontrollet për verifikimet kufitare.

37-vjeçarit iu sekuestruan në tetor edhe 39 makina luksoze dhe 6 motomjete

ELBASAN

Afro dy muaj pas arrestimit të Kastriot Kilës për llogari të drejtësisë italiane, Prokuroria e Elbasanit ka sekuestruar pasurinë e tij, e cila kap vlerën 71 milionë lekë të reja, pasi dyshohet se është siguruar nga aktiviteti i tij kriminal. Burime zyrtare nga organi i akuzës dhe bënë me dije se ka vendosur sekuestro preventive për pasuritë Elton Kilës alias Kastriot Kila në Elbasan. Mësohet se me kërkesë të prokurorisë së këtij rrethi i ekzekutua vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, nr. 913, datë 07.12.2018, për sekuestro preventive për pasuritë: një ndërtesë 5-katëshe me sipërfaqe banimi 1502 m², në Elbasan; njësi shërbimi me sipërfaqe 400 m², në Elbasan dhe një sipërfaqe toke prej 5200 m², në Elbasan. Ndërsa është vendosur sekuestro 100% të kuotave të zotëruara nga shtetasja I.K. në shoqërinë tregtare "KILA TRANS" sh.p.k. Sipas burimeve të mësipërme, vlera e blerjes së këtyre pasurive nga 37-vjeçari Elton Kila alias Kastriot Kila, të deklaruara në deklaratat noteriale të përpiluara te noteri, kap shumën prej 70.819.000 lekë të reja. Ndërkohë që vlera aktuale e tregut e këtyre pasurive është shumë herë më e madhe. Për Kastriot Kilën janë transaksione financiare të dyshimta, kryer në bankat e nivelit të dytë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme si dhe biznese në emër të tij dhe lidhjeve të tij familjare, të cilat dyshoheshin se burojnë nga aktiv-

U arrestua 2 muaj më parë, i sekuestrohen 71 milionë lekë pasuri Kastriot Kilës

Prokuroria: Dyshohet se i ka vendosur nga aktiviteti kriminal në Itali



Elton Kila alias Kastriot Kila

iteti kriminal, kryer në Itali. Ndërkaq, po të njëjtat burime pohuan se hetimet vazhdojnë për të verifikuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme si dhe llogari bankare të dyshuara me prejardhje kriminale. Në tetor të këtij viti, Kilës i janë sekuestruar edhe 39 makina luksoze dhe 6 motomjete në 3 pika shitje të mjeteve, të dyshuara se janë të përfituara nga veprimtaria kriminale. 37-vjeçari Kastriot Kila u arrestua nga policia e El-

basanit gjatë aksioneve të befasishme në lokale dhe akse rrugore, më 18 tetor me qëllim ekstradimi për në Itali. Kjo për faktin se Prokuroria e Peskarës/Itali kishte lëshuar ndaj tij urdhrin e ndalimit ndërkombëtar, datë 11.09.2018, për kryerjen e veprave penale: "Organizata kriminale", "Trafikimi i narkotikëve", "Mashttrim" dhe "Kallëzim i rremë".

ARRESTIMI

37-vjeçari Kastriot Kila u arrestua nga policia e Elbasanit gjatë aksioneve të befasishme në lokale dhe akse rrugore, më 18 tetor, me qëllim ekstradimi për në Itali. Kjo për faktin se Prokuroria e Peskarës/Itali kishte lëshuar ndaj tij urdhrin e ndalimit ndërkombëtar datë 11.09.2018, për kryerjen e veprave penale: "Organizata kriminale", "Trafikimi i narkotikëve", "Mashttrim" dhe "Kallëzim i rremë".



Formohet Këshilli i Lartë i Prokurorisë, zgjidhen 6 anëtarët

TIRANË - Njëmbëdhjetë dhjetori i këtij viti do të shënohet në kalendar si një ditë kthesë në historinë e drejtësisë shqiptare, pasi mori jetë një ndër institucionet më të rëndësishme në kuadër të reformës në drejtësi. Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Pas shumë zvarritjesh, 295 prokurorë nga 305 në total votuan dhe zgjodhën gjashtë anëtarë të Këshillit, çka i hap rrugë krijimit të Prokurorisë Speciale, një institucion që do të hetojë korrupsionin në nivele të lartë. Procesi i votimit nisi në orët e para të mëngjesit, për të përfunduar në mbrëmje vonë. Në garë për gjashtë vende ishin 10 kandidatë nga të gjitha nivelet. Ndryshe nga sa thuhej nën zë se mbledhja e përgjithshme e prokurorëve mund të bojkotohej, në fakt ndodhi krejt ndryshe. Pjesëmarrja ishte masive dhe nuk pati asnjë debat. Mesa duket, në këtë pikë ndikuan jo pak thirrjet që ditë e fundit lëshuan selitë kryesore diplomatike në Shqipëri. Në fund të procesit u bënë publike edhe emrat e të votëbesuarve, që së bashku me pesë anëtarët joprokurorë të zgjedhur prej një viti do të marrin në duar frerët e prokurorisë shqiptare. Kështu, nga Prokuroria e Përgjithshme u zgjodh Kosta Beluri, i cili do të fitues përballë Anila Lekës. Prokurorët e Apeleve. Arben Dollapaj dhe Bujar Sheshi u shpallën automatikisht fitues, përderisa nuk kishte konkurrencë në garë. Më e ethshme ishte gara me 6 kandidatëve të prokurorëve të shkallëve të para, ku vetëm tre prej tyre do të mund të dilnin fitues. Mes tyre, më shumë vota grumbulluan Antoneta Sevdari, Gentian Osmani dhe Besnik Cani, duke zënë kështu tri vende në Këshill. Dritan Prençi, Besnik Muci dhe Vate Staka nuk i bindën dot kolegët për t'i votëbesuar si anëtarë të qeverisë së institucionit të akuzës. Që nga ky moment posti i prokurorit të Përgjithshëm do të jetë honorifik, pasi njerëzit e akuzës do t'i japin llogari përpara Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Pasi të konstituohet, një nga detytrat parësore që Këshilli duhet të përmbushë është hapja e garës për prokuror të përgjithshëm, post që mbahet përkohësisht prej një viti nga Arta Marku. **kl.la.**

PASURITË E SEKUESTRUAR

1. Një ndërtesë 5-katëshe, me sipërfaqe banimi 1502 m², në Elbasan.
2. Njësi Shërbimi me sipërfaqe 400 m², në Elbasan.
3. Një sipërfaqe toke prej 5200 m², në Elbasan.
4. Sekuestro 100% të kuotave të zotëruara nga shtetasja I.K., në shoqërinë tregtare "KILA TRANS" sh.p.k.
5. Në tetor Kilës iu sekuestruan edhe 39 makina luksoze dhe 6 motomjete në 3 pika shitje të mjeteve, të dyshuara se janë të përfituara nga veprimtaria

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Permbartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adrese Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se më datë 20.12.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i rre për shitjen e 4 pasurive të paluajtshme , në pronësi të: Shoqërisë "VICTORY INVEST" SH.P.K me vlera fillestare ne ankand: a) 252,668 (Dyqind e pesëdhjet e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjet e tetë) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,795 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/66, Vol.18, Fq.152, ZK.2704 b) 244,632 (Dyqind e dyzet e katër mijë e pesëqind e tridhjet e dy) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 2,705 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/67, Vol.18, Fq.153, ZK.2704 c) 316,400 (Treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 3,500 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/72, Vol.19, Fq.146, ZK.2704 c) 135,600 (Njëqind e tridhjet e pesë mijë e gjashtëqind) USD për Pasurinë e paluajtshme, Ullishte me sipërfaqe totale 1,500 m², regjistruar në Z.V.R.P.P Tiranë me Nr.pasurie 547/73, Vol.19, Fq.147, ZK.2704.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Mediat greke: 7 persona ushtruan dhunë ndaj të riut, 2 janë identifikuar

Akuzohet për vrasjen e studentes greke, rrihet barbarisht në qeli shqiptari Aleksandër Luca


20-vjeçari: Më sulmuan 20 të burgosur, u zgjova në një dhomë tjetër pa pantallona

GREQI

Aleksandër Luca, i cili akuzohet për vrasjen e studentes 21-vjeçare Eleni Tofaloudi, është rrahur barbarisht pasditen e së hënës në qelitë e burgut nga të burgosur të tjerë. Ngjarja e rëndë ka ndodhur në burgun e Avlonës, afro dy javë pas vrasjes së të resë greke në ishullin e Rodos. Mediat greke kanë publikuar dje pamje të filmuara nga vetë të dënuarit, ku shihen duke dhunuar 20-vjeçarin shqiptar. Mësohet se të burgosurit e tjerë kanë hyrë në qelinë ku ndodhet Luca dhe më pas e kanë sulmuar atë verbalisht dhe fizikisht. Njëkohësisht e pyesnin edhe përse bëri krimin në Rodos. "Nuk e bëra unë, e bëri ai tjetri", u përgjigjet 20-vjeçari shqiptar, duke akuzuar shokun e tij grek, Manolis Koukouras, bashkëpunëtor në ngjarje. Pas dhunës, Aleksandër Luca ka marrë ndihmën e parë mjekësore në burgun në fjalë dhe më pas është dërguar në spitalin "Evangelismos". Ndërkohë, autoritetet greke kanë nisur një hetim të brendshëm për të zbuluar se si të burgosurit e tjerë u futën në qelinë e shqiptarit Luca. Ky i fundit dhe bashkëpunëtori i tij grek, Koukouras janë vendosur në burgje të ndryshme. Nga ana tjetër, TV "Klan" (u referohet mediave greke) bënë me dije se 20-vjeçari shqiptar është shprehur para autoriteteve të këtij vendi se u dhunua nga rreth 20 persona dhe më pas i ra të fikët dhe se kur u zgjua e gjeti veten në një dhomë tjetër dhe pa rroba. "Dëgjova dikë që u bënte thirrje të tjerëve të më hiqin pantallonat dhe pastaj më ra të fikët. Kur u zgjova, isha në një dhomë tjetër, pa pantallona dhe pa të brendshme. Nuk e di se çfarë mund të kenë bërë me mua", ka thënë Aleksandër




20-vjeçari i dhunuar në burg Aleksandër Luca



Luca. Pas dëshmisë së tij, mjekët do të verifikojnë nëse i riu shqiptar është abuzuar nga të burgosurit e tjerë. Gjithashtu, mediat e vendit fqinj raportuan ditën e djeshme se kanë qenë 7 persona që ushtruan dhunë ndaj 20-vjeçarit. Dy prej tyre janë identifikuar. Njëri është grek, kurse tjetri shtetas i

huaj. Një tjetër i burgosur, i cili ka qenë me grupin e dhunuesve, ka pohuar në një lidhje direkte për një televizion të Athinës se derën e qelisë së Aleksandër Lucës e gjetën të hapur. Të burgosurit që e goditën ishin të gjithë me thika - tha ai - duke shtuar se gardiani nuk mund të bënte asgjë.



Studentja e vrasë Eleni Tofaloudi

DESHMIA

Mediat greke bënë me dije se 20-vjeçari shqiptar është shprehur para autoriteteve të këtij vendi se u dhunua nga rreth 20 persona dhe më pas i ra të fikët dhe se kur u zgjua, e gjeti veten në një dhomë tjetër dhe pa rroba. "Dëgjova dikë që u bënte thirrje të tjerëve të më hiqin pantallonat dhe pastaj më ra të fikët. Kur u zgjova, isha në një dhomë tjetër, pa pantallona dhe pa të brendshme. Nuk e di se çfarë mund të kenë bërë me mua", ka thënë Aleksandër Luca. Pas dëshmisë së tij, mjekët do të verifikojnë nëse i riu shqiptar është abuzuar nga të burgosurit e tjerë.

VRASJA E STUDENTES

Ngjarja për të cilën akuzohet Aleksandër Luca dhe shoku i tij grek, 21-vjeçari Manolis Koukouras ndodhi mbrëmjen e 27 nëntorit të këtij viti në ishullin e Rodos. Studentja greke, Eleni Tofaloudi u vra nga dy të rinjtë pasi refuzoi kërkesën e 20-vjeçarit shqiptar dhe të mikut të tij grek 21 për të shkuar në shtëpinë e këtij të fundit dhe të kryenin marrëdhënie seksuale. Mediat greke shkruajnë se pasi e goditën me një shufër hekuri pas kokës, të rinjtë e

lidhën me litar nga këmbët vajzën dhe e hodhën në det, pasi e pandehën të vdekur. Trupi i të ndjerës u gjet në nesërmen e 28 nëntorit. Por sipas raportit mjeko-ligjor e reja vdiq nga mbytia dhe jo nga goditja pas koke. 21-vjeçari grek i përfshirë po ashtu në vrasje, njihet si fëmija e një familjeje shumë të pasur, ndërsa ka punësuar avokatim më të mirë në Greqi. Ndonëse shqiptari tha se kishte qenë Manolis Koukouras ai që kishte qëlluar vajzën e re, ky i fundit ia ka hedhur fajin shqip-

tarit. Në këtë pikë, hetuesit grekë kanë dy dëshmi nga të pandehurit, të cilët akuzojnë njëri-tjetrin. Idyshuari Manolis Koukouras ka thënë në dëshmi se shoku i tij Aleksandër Luca e qëlloi me hekur në kokë, pasi u mërzit kur ajo i tha se "kësi me të nuk ishte aq i mirë sa me shokun e tij", raportuan mediat greke një ditë më parë. Megjithatë, hetimet janë ende në vijim dhe policia mendon se në ngjarje mund të jetë i përfshirë edhe një person i tretë.

HETIMET

Nga hetimet e deritanishme janë evidentuar 7 të burgosur që ushtruan dhunë ndaj Aleksandër Lucës. Njëri prej tyre, duke folur për një emision në Greqi, ka thënë se të gjithë kishin thika, ndërsa derën e qelisë së 20-vjeçarit e gjetën hapur. "Gardiani - tha ai - nuk mund të bënte asgjë kundër 7 të burgosurve me thika", Aleksandër Luca, pas trajtimit që mori në spital, u dërgua në një tjetër burg për të garantuar sigurinë e tij. Ai nuk ka pësuar lëndime të rënda nga dhuna e ushtruar.

Suedi Sverige

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

INSTITUTE OF STATISTICS OF ALBANIA

TENDER NOTIFICATION

Institute of Statistics of Albania intends to award a contract for **Workstations advanced** in Tirana, Albania, with financial assistance from Sweden, represented by the Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) under the project: Direct funding for procurement of IT-equipment and establishing a training centre, with Sida contribution nr: 55020289.

The tender dossier is available at <http://www.instat.gov.al/all/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>: from **November 28, 2018**. The deadline for submission of tenders is: **December 27, 2018, time 15:00 hrs**, at Institute of Statistics of Albania, Str. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, 1017 Tirana, Albania.

Possible additional information or clarifications/questions shall be published on the <http://www.instat.gov.al/all/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>.

Tenders may request clarification on any of the documents of the Tender up to 14 days before the date of submission of offers.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

NJOFITIM TENDERI

Në kuadër të projektit: "Financim direkt për prokurimin e pajisjeve të IT-së dhe ngritjen e qendrës së trajnimit, "Sida contribution nr: 55020289", financuar nga qeveria Suedeze, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), Instituti i Statistikave (INSTAT), Tiranë, do të zhvillojë procedurën e prokurimit me objekt: **Workstations advanced**.

Dokumentat e tenderit mund ti gjeni në adresën: <http://www.instat.gov.al/all/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>, nga data **28.11.2018**. Afati i fundit i dorëzimit të ofertave është: **27.12.2018, ora 15:00**, në adresën: Instituti i Statistikave, Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, 1017 Tirana.

Informacionet shtesë ose sqarime/pyetje, do të publikohen në: <http://www.instat.gov.al/all/rreth-nesh/procedura-prokurimi/>.

Kërkesa për sqarime mund të dorëzohen pranë Autoritetit Kontraktor, deri në 14 ditë para ditës së fundit për dorëzimin e ofertave.

Avokati i viktimës: Sjellje të tilla nuk duhet të ndodhin

Reagon Ministria greke e Drejtësisë: Dhuna ndaj të burgosurit shqiptar, e papranueshme

GREQI - Pas dhunimit të 20-vjeçarit shqiptar në qelitë e burgut të Avlonës ka reaguar Ministria greke e Drejtësisë, e cila e konsideruar të papranueshme dhunën e ushtruar ndaj tij. "I paraburgosuri A.L. 20 vjeç ishte vendosur në një dhomë të veçantë pas urdhrave të qarta të ministrisë për mbrojtjen dhe sigurinë e tij. Megjithatë, dje pasdite u sulmua në qelinë e tij nga të burgosurit e tjerë dhe u dërgua në qendrën shëndetësore Kapandriti dhe më pas në spitalin "Evangelismos" për kontroll. Ai u trajtua dhe nuk ishte e nevojshme shtrimi në spital

nuk duhet të ndodhin, edhe pse Aleksandër Luca është një nga dy të dyshuarit për krimin e rëndë. "Fajin dhe dënimin për të burgosurit e përcaktojnë vetëm gjyqtarët dhe kjo ngjarje është e papranueshme për një vend demokratik si Greqia", u shpreh avokati i familjes së viktimës.

AVOKATI I VIKTIMËS
Gjithashtu, në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar edhe avokati i familjes së vajzës, Alexis Kougias. Duke folur për shtypin grek, ai ka thënë se sjellje të tilla nuk duhet të ndodhin, edhe pse Aleksandër Luca është një nga dy të dyshuarit për krimin e rëndë.

dhe u kthye në burg. Ka nisur një hetim disiplinor për incidentin dhe hetim penal për të burgosurit", thuhet në deklaratën e Ministrisë greke të Drejtësisë. Gjithashtu, në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar dhe avokati i familjes së vajzës, Alexis Kougias. Duke folur për shtypin grek, ai ka thënë se sjellje të tilla

Lista e re/ Ministria e Financave publikon emrat e personave që marrin këstin e tretë të dëmshpërblimit

1400 të përndjekurit që marrin kompensimin

Tabela me çdo dokument që mungon në secilën dosje të trashëgimtarëve

Rreth 1400 trashëgimtarë të ish-dënuarve politikë që presin të marrin këstin e tretë duhet të plotësojnë dokumentacionin që u mungon në dosje për të marrë me pas paratë. Lista është bërë publike dhe nga Ministria e Financave. Bëhet fjalë për përfitues të kategorisë jo parësore që do të trajtohen me dëmshpërbim, por që sipas këtij dikasteri duhet të dorëzojnë dokumentet. Ministria e Financave u kërkon përfituesve të këstit të dytë të dorëzojnë në Drejtorinë e Pagesave numrin e llogarisë për të marrë dëmshpërbimin. Të gjithë personat



kanë afati deri më 26 shkurt 2019 për të plotësuar dosjen.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një germë të vetme në krahasim me

dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutiveve pa gjyq.

EMRAT ME PËRFITUESIT E KOMPENSIMIT TË PËRNDJEKURVE

NR. DOSJES	EMER	MBIEMER	EMER	ATESEA	MBIEMER	ROPIE VE LETËR NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIT BANKARE	CERTIFIKATE VEDEKJE	CERTIFIKATE E TRINGUT FAMILJAK	BESIMI TRASHGIMIE	PROKUROR	CERTIFIKATË GJENDJE CIVILE
3210	LOLI	DHAMANDI	MARTA	LOLI	DHAMANDI	V	V	V	V	V		
172	AVNI	ZHITI	LIRI	AVNI	MËRTEZA	V	V	V	V	V		
881	SAMI	PASHAJ	BEHARE	AGUSH	PASHAJ	V	V	V	V	V		
7685	XHELAJ	NDREU	AVNI	XHELAJ	NDREU	X						
11403	ISUF	NIKA	ISUF	ISUF	VATA	V	V	V	V	V		
603	GJOKE	DACAJ	ANTON	GJOKE	DACAJ	V						
7841	ETHEM	BAKALLI	GILMAN	ETHEM	BAKALLI	X	X					
8535	ALEKS	CEMI	FATMIRA	MAHMUT	CEMI	V	V	V	V	V		
11355	SVRJA	GOLJA	DIELE	PAL	SIMONI	V	X	X	X	V		
10322	GJON	DEDA	DIELE	PAL	SIMONI	V	X	X	X	V		
10480	BASRI	KADILI	BASHIM	BASRI	KADILI	V	V	V	V	V		
3344	ARIF	TABARU	BURURI	ARIF	GJOSHI	X						
195	MHILL	BUSHGJOKAJ	LENE	MUSE	BUSHGJOKA	X						
2503	REXHEP	LLOCI	BAJAME	REXHEP	LLOCI	V	V	V	V	V		
4254	QEMAL	SUEKA	ENVER	REXHEP	LLOCI	V	V	V	V	V		
1114	BEQIR	OMARI	MUHAMMED	REXHEP	LLOCI	V	V	V	V	V		
11050	KOZMA	DADOLLI	AYLEFQARI	ARIF	OMARI	V	X	V	V	V		
3339	MUHAMMED	FERKO	LIJAN	MUHAMMED	FERKO	V	V	V	V	V		
7635	NIKOLLA	SKANA	LAURA	NIKOLLA	SKANA	V	V	V	V	V		
287	TUNI	BARE	NAJUN	TUNI	BARE	V	X	V	V	V		
3344	RAMADAN	KADRIU	VERA	RAMADAN	PIRA	V	V	V	V	V		
2381	HAMIT	KROI	BESSNIK	HAMIT	KROI	X				X		
1133	MEXHIT	METHASANI	SABRI	MEXHIT	METHASANI	V	X	V	V	V		
			MUNIR	MEXHIT	METHASANI	V	V	V	V	V		
			XHAHIT	MEXHIT	METHASANI	V	V	V	V	V		
			DUSTAN	MEXHIT	METHASANI	V	V	V	V	V		

2538	VEHAP	KADRIU	BARIE	MUSI	KADRIU	V	V	V	V	V		
			BARIAM	HASAN	KALAJA	V	V	V	V	V		
			LEMBRE	VEHAP	CENANDEMIR	V	X					X
			GANJE	VEHAP	KADRIU	V	X					
			FESTIME	VEHAP	BANA	V	X					
			MERJEME	VEHAP	SEHRI	V	X	V			ZV	
						V	X					
						V	X					
740	HASAN	KALAJA	NAJFE	BEKTASH	KALAJA	V					V	V
			SADRK	HASAN	KALAJA	V	X	V	V	X		
			GEZIM	HASAN	KALAJA	X	X					
			FATMIR	HASAN	KALAJA	X	X					
			BARDEHI	HASAN	KALAJA	X	X					
			SHPETIM	HASAN	KALAJA	X	X					
			HAFSA	HASAN	KALAJA	V	V					
3051	MARTIN	LUCA	ELIR	HASAN	KALAJA	X	X			V	V	V
			DIELL	MARTIN	LUCA	V						
			DIELE	MARTIN	SHPATI	V						P
			IRJANE	MARTIN	OTHEJA	V						P
			GJELNE	MARTIN	KALAJ	V	V					V
			GJON	MARTIN	LUCA	V	V					
			JOLANDA	MARTIN	NIKAJ	V						P
			KATRINE	MARTIN	PRELA	V						P
			LIJE	MARTIN	SHPATI	V						P
			TEREZZNA	MARTIN	SUFAT	V						P
13822	KOCO	THEODHOSI	MIRANDA	LONI	THEODHOSI	V					V	V
			ARBEN	KOCO	THEODHOSI	V	X					V
			NINA	KOCO	THEODHOSI	V	X					V
10081	PERIKLI	LIFE	PANDELI	PERIKLI	LIFE	V	X			V	X	V
14802	REXHEP	DORRISH	KADOKUMENTA									
11253	MAN	SVLAJ	FRAN	MHILL	BUSHGJOKA	X						
			ISA	MAN	SVLAJ	X	X				V	V
			BAHRAM	MAN	SVLAJ	X	X				V	V
										V	X	
12444	SPIRO	DISHO	KATRINA	NIKO	DISHO	V					V	V
			KESHILLA	SPIRO	DISHO	V	V				V	V
5414	PRENG	GJONI	DAVE	DED	GJONI	V					V	V
			DALJANA	PRENG	GJONI	V	V				V	X
			DED	PRENG	GJONI	V	V					
			GJERGJ	PRENG	GJONI	V	V					
			GJON	PRENG	GJONI	V	V					
			NJJE	PRENG	GJONI	V	V					
			PRENA	PRENG	MEDJANI	V	V				V	V
15010	TOM	MARINAI	MRI	MARINAI	X	X						
			LIJNE	TOM	GJEKAI	V	X					
			GHETO	TOM	MARINAI	V	X					
			NJKE	TOM	MARINAI	X	X					
			MURADES	NEXHIP	RLOJ	X						P
			VIOLETA	NEXHIP	SHERRI	X						P
9816	TEOFIK	BEKTESHI	ALBERT	HASAN	LAMBE	X	X				V	V
			LIJNIE	HASAN	BEKTESHI	V	V				V	V
4239	MARK	NIKOLLI	MARIE	TOM	NIKOLLI	V	X				V	V
			FREDERIK	MARK	NIKOLLI	X					V	P
8595	SHPRESA	CEKA	HASAN	REXHEP	HASAN	V	X				V	V
			MAKBULE	CEKA	V	X					V	V
1862	MERSET	MALUKA	KURBUDIN	MALUKA	X	X					V	V
			FOREM	SEPULLA	MALUKA	X	X				V	P
			IBARTE	SEPULLA	GUSHO	X						
9750	SULEJMAN	MULLA	DRITAN	SULEJMAN	MULLA	V	X				V	V
			VIL	SULEJMAN	MULLA	X	X				V	V
6906	MIKEL	RADOVANI	DOMENIKA	NDJOC	RADOVANI	V	V				V	V
			MIKEL	RADOVANI	V	V						P
2974	HASAN	RECI	ALKEI	MIRGJ	SLEJMAN	V	V				V	V
6564	QERIM	JAKUPI	RIJKE	HASAN	RECI	X	X				V	V

Table with multiple columns containing names and numbers, including entries like 9832 NIKOLLI BEQARI, 9227 BEKHET SHEFRI, 8251 JORGJI BUDO, 10146 SHUKRI BULICA, 10547 LEKA DOSTI, 11076 ISLAM SEFERI, 9088 SHPEND SELIMAJ, 7777 SELAMI TIRANA, 8126 ASTRIT KAMJENI, 1087 DULE Tafa, 1071 DESTAN KALOSHI, 2771 AGIM TETA, 1665 GAFUR JHJENI, 3263 VANDEJ SAMARA, 4396 KAJMAK XHILAGA, 4320 XHEVDET HJSA, 1056 AVDI PEPOSHI, 817 HAZIS BEKHETI, 2189 GJON MATRIZI, 1955 LIJO CALAJ, 2618 ALI ZENEJA, 2829 SERVET SORRA, 1208 FETI GREMI, 425 GJON MARASHI, 1950 ULIS DELJU, 2108 PANAJOT BABA, 7656 CEZIM GAZHJELI, 11548 NAMIK ZENEJAJ, 9144 NASTRADIN MEMINAJ, 10721 PASHUK TUSHA, 4088 HAKI LIMI, 4234 FLAMUR FUSHA, 1511 KOL KIRI, 14170 ANGEJIN COBA.

Table with multiple columns containing names and numbers, including entries like 4664 BASTIAR NDBREU, 13876 ARISTOTEL PAPA, 4388 DEMIR THACI, 10286 VILI GHONCAJ, 4628 NDOK ANAJ, 8455 ISLAM LLESHI, 8254 NDBREC CUPI, 14171 MIKEL COBA, 9840 VLADIMIR DHORA, 11016 RAMIZ KACA, 9660 EHIP KURTELLA, 7726 SHABAN HOXHA, 5013 Reshat Oparaku, 514 Piro Pisoni, 2339 Kamber Bejko, 7574 Bardok Jaku, 242 Emel Shkara, 506 Haki Baiku, 836 LATIF BEKTESHI, 4393 Gjon Nikollaj, 2897 SELFO PASHAJ, 1079 SULEJMAN HOXHA, 5367 PANO PRIETAJ, 6632 ARTAN QIRKO, 8750 FAIK MURARAJ, 10043 NESMI SHEHU, 2774 MEHDI AGOLLI, 368 LEONIDHA KUME, 28515 Gjerok Marqizi.

VIP

Suplement
Pages

Emërkurë 12 Dhjetor 2018 GAZETA SHQIPTARE

"BULEVARDI POLITIK"

- Rama: Tako hem me Bashën, por ai mban 1 kilometër distancë
- Sa të lumtur janë deputetët kur ikin në SHBA
- Kryeministri indian Modi, lideri botëror më i ndjekur në "Instagram"
- Tirana në protestë, Korça ndez magjishëm dekorin e festave

Keisi Tola dhe Flori Mumajesi në një lidhje? Ja fotot që na ngrenë dyshime



Aktori shqiptar prezanton 'Fest 57', ja e famshmja ndërkombëtare që i bashkohet



Flet këngëtarja e "Aq sa më do":
Baladat flenë shumë mirë tek unë



**Rrëfëhet Xhoi Kallaverja: Në
"Kënga Magjike" vihej re kush
ishte 'Big' e kush ishte "New Artist"**

*"Kam nevojë të identifikohem me emrin tim,
por jam e hapur për bashkëpunime"*

Flet këngëtarja e "Aq sa më do": Baladat flenë shumë mirë tek unë

Rrëfihet Xhoi Kallaverja: Në "Kënga Magjike" vihej re kush ishte 'Big' e kush ishte "New Artist"

"Kam nevojë të identifikohem me emrin tim, por jam e hapur për bashkëpunime"

Pamela Aliaj

Në festivalin e Këngës Magjike këtë vit spikatën shumë zëra të rinj, të cilët mund të themi me plot gojë se ishin 'magjia' e vërtetë e këtij edicioni të 20-të. Një nga këto zëra ishte padyshim edhe Xhoi Kallaverja, bukurshja nga Peshkopia, e cila arriti të ishte edhe në finalen duke konkurruar për "New Artist". Në një intervistë për "Vip Pages" të "Gazeta Shqiptare", Xhoi na rrëfen për prapaskanat dhe emocionet e kaluara në netët live në Pallatin e Kongreseve. Gjithashtu, këngëtarja ka folur edhe për pasionet e saj jashtë kuadrit të muzikës si dhe projektet e saj të radhës. Për më tepër në intervistën e mëposhtme.



Paçka se unë kam mbaruar studimet për diplomaci, unë jetoj dhe punoj me muzikën. Besoj që tashmë kënga është kthyer në profesion për mua dhe mendoj me mbështetje dhe publikut të vazhdoj gjatë kështu.

Cili është zhanri i këngës që identifikoheni më tepër përveç baladës?

Unë di të them që baladat flenë shumë te unë po kjo s'do të thotë që unë nuk i këndoju zhanre të tjera të muzikës duke filluar që nga ato ritmikët të muzikës së lehtë e të huaj duke vazhduar deri nga ato qytetare popullore.

Keni ndonjë personazh që ju i dedikoni zgjedhjes së kësaj rruge që besoi te ju?

Absolutisht që po! Familja zë një pjesë shumë të rëndësishme për mua dhe si e tillë e kam pasur dhe vazhdoj ta kem përkrahjen e tyre! Dua të veçoj një person shumë special në këtë rrugëtim të gjatë, mamin tim e cila më ka zbuluar talentin që e vogël dhe ka qenë mbështetja ime më e madhe dhe dua t'i them publikisht "Faleminderit! Ti je muza ime!".

Ç'mendim keni për këngëtarët e rinj të sotëm si ju që mundohen të identifikohen në tregun e muzikës? Më shumë sipas jush vlerësohet imazhi apo talenti?

Di vetëm të them që ka prurje dhe talente në fushën e muzikës së lehtë. Këtë e vërtetoj mjaft mirë edicioni i 'Këngës Magjike' ku shihet dhe nuk vihej re kush ishte Bigu dhe kush ishte "New Artist". Imazhi mendoj që është kontakti i parë me publikun si në çdo fushë të jetës, por kur të dyja ndërthuren bashkë si imazhi dhe talenti është akoma më mirë mund të them që je me fat, dhe unë mendoj se e kam këtë fat. (Qesh) Shaka kjo!

Çfarë vendi pretendoni me këngën tuaj tek "Kënga Magjike"?

Për mua ishte një arritje përderisa arrita në netët finale e të këndoja në një skenë me Big-ët e muzikës shqiptare aq më tepër në 20-vjetor të Këngës Magjike.

Cili është projekti juaj i radhës?

Për momentin do mbyllem festat e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri ku unë do jem e angazhuar si çdo vit. Projektet me të reja ristartojnë në fillimin e 2019 dhe shpresoj të sjell diçka ndryshe dhe më me ritëm.

A do të shohim me ndonjë këngë tuajën apo bashkëpunim?

Mendoj se kam nevojë të identifikohem me emrin tim po kjo s'do të thotë që unë nuk jam e hapur për një bashkëpunim të mundshëm.

Doja ta mbyllja këtë intervistë duke ju falënderuar dhe gjithashtu, mirënjohje dhe dashuri për të gjithë ato që më kanë mbështetur në këtë rrugëtim. Në këto ditë prag festash ju uroj festat gjithë shqiptarëve kudo që ndodhen, lumturi dhe fat në jetë përherë!

Si nisi pasioni juaj për këngën?

Karriera ime zë fill që në fëmijërinë time që në moshën 6 vjeç ku kam marrë pjesë në kompeticionet e Festivaleve të Fëmijëve në vendin tim të lindjes Peshkopi/Dibër! Më pas kam qenë pjesë e Estradës të Peshkopisë deri 18-vjeç! Me ardhjen e studimeve në Tiranë nuk jam ndarë këtij pasioni për muzikën duke qenë pjesë e shumë ambienteve ku luhej muzikë live.

Cila ka qenë performanca që ju ka lënë më tepër mbresa brenda apo jashtë vendit?

Kam pas shumë gjëra të bukura në jetën time artistike, por do të veçoja edicionin e fundit të festivalit 'Kënga Magjike', ka qenë vërtet emocion i papërsëritshëm netët live të këtij kompicioni me shoqërojnë akoma në këto momente që po flasim, ka qenë vërtet magji për mua që më kanë lënë mbresa shumë të bukura e që janë gjëra që vijnë rrallë në jetë dhe lënë gjurmë.

Pse zgjidhët pikërisht "Kënga Magjike 2018" për të konkurruar dhe jo një event tjetër muzikor?

Zgjedha 'Këngën Magjike', sepse gjithmonë kam ëndërruar të jem pjesë e një skene aq madhështore e kaq magjepsëse, siç është 'Kënga Magjike'. Erdha më e pjekur artistikisht dhe aq më tepër në 20-vjetorin e saj.

Nga u frymëzuar për këngën "Aq sa më do"?

Për të ardhur deri në finalizimin e një produksioni muzikor janë shumë komponente si muzika teksti orkestracioni, kompozitori i kësaj kënga Gent Myftaraj mendoi se mua më rrinte mjaft mirë një gjë ëmbël që vjen natyrisht në vesh të publikut, siç është "Aq sa më do" me poezi të En-

drit Mumajesit.


Çfarë bën Xhoi jashtë korvizave të këngës në jetën e përditshme?

Përveç aktiviteteve të mia artistike, vazhdimësia e një dite të

zakonshme për mua fillon me kafën e mëngjesit nën shoqërinë e njerëzve që më japin pozitivitet dhe kjo gjë është shumë e rëndësishme për mua për të pasur një ditë produktive, pastaj palester e

takime pune. Më pëlqejnë shumë udhëtimet, të ngas makinën e të play-uj muzikën time të preferuar e pse jo dhe me volum të lartë.

Cili është profesioni që keni zgjedhur?



Edhe pse temperaturat këtë muaj janë ulur shumë mesa duket jo të gjithë e ndjehmë të ftohtin. Disa prej nesh përkundrazi edhe e shijojnë atë duke dalë në dëborë vetëm me një veshje të hollë. Të njëjtën gjë ka bërë edhe këngëtarja Poni. Ajo ka postuar një foto ku vjen me një poze në borë, vetëm në fustan. Megjithatë jashtë po mbretërojnë temperatura të ulëta që po sjellin edhe borë, Poni duket se nuk e ka problem. Këngëtarja ka dalë në një terracë ku po shijon boren që po bie e veshur vetëm në një fustan të hollë, duke ekspozuar shumë trupin. Poni tregon format në fustanin e gjatë, në ambientin që duket se ka zgjedhur për të kaluar disa ditë relaks.



Poni sfidon të ftohtin, del e zhveshur në dëborë

Ajo është një nga këngëtares me të ndjekura të momentit. Por si çdo femër edhe ajo e ndjen se ka ardhur ndoshta momenti për të sjellë një fëmijë në jetë. Po flasim pikërisht për këngëtares Dafina Zeqiri e cila mendon se do të ishte një nënë 'cool'. Ajo kohët e fundit po shijon disa ditë pushimi në Miami, me familjarë të saj. Ajo po sjell vazhdimisht fotografi provokative, ndërsa me postimin e fundit ka befasuar të gjithë, shkruan Gazeta Express. Dafina ka publikuar një foto me një fëmijë, ndërsa shkruan se e din se duhet ta bëjë një fëmijë, pasi mendon se do të ishte një nënë shumë 'cool'.



Gati për t'u bërë nënë? Dafina befason me deklaratën e saj



Pas fitores në Kënga Magjike 2018, Flori Mumajesi ka qenë në qendër të vëmendjes këto ditë. Por dje këngëtarja e ktheu të gjithë vëmendjen te jeta e tij personale me postimin e fundit në "Instagram". Flori ka publikuar një foto nga momenti kur interpreton me Keisi Tolën këngën "Më ke mua", dje tek "Post Kënga Magjike", në studion e të Dieles këngëtarja. "Mërzitem edhe unë me ty ndonjëherë, më shumë për gjëra koti që nuk kanë vlerë. Por e gjej gjithmonë një motiv më fal të them, s'te gënjej dot përmendesh ti më njeh", shkruhet në foto, një frazë e shkëputur nga teksti i këngës së Keisit. Mirëpo dyshja dje në "Post Kënga Magjike" u shfaqën shumë të afert me njëri-tjetrin. Teksa Keisi këndonte, Flori e përqafoi, i drejtohej me fraza nga teksti i këngës, bënte gjeste romantike dhe kaq është dashur që të përfillet se ata janë në një lidhje. Të jetë e vërtetë?

Keisi Tola dhe Flori Mumajesi në një lidhje? Ja fotot që na ngrenë dyshime



Padyshim që një nga eventet më të shumëpritura të fundvitit është edhe çdo fundvit në Pallatin e Kongreseve në Tiranë. Në të marrin pjesë këngëtares të rinj dhe këngëtares të afirmuar më dëshirën e madhe për të përfaqësuar Shqipërinë në 'Eurovizion'. Këtë vit personazhi që është përzgjedhur për të drejtuar festivalin e 57-të është aktori i madh Viktor Zhusti. Viktor Zhustin e kemi parë të interpretojë në shumë role, por kësaj here do ta shohim nën moderimin e festivalit të fundvitit. Krahas tij do të shfaqet edhe ylli ndërkombëtar Ana Golja, aktore shqiptaro-kanadeze dhe producente shumë e suksesshme. Ajo njihet për rolet e saj të shumta në seriale amerikane. Do të jetë padyshim një eveniment shumë i veçantë.

Aktori shqiptar prezanton 'Fest 57', ja e famshmja ndërkombëtare që i bashkohet

BOULEVARDI

Na merrni seriozisht!

POLITIK

Rama: Takohem me Bashën, por ai mban 1 kilometër distancë

Kryeministri Edi Rama i përgjigjet me humor batutës së një komentuesi në "Facebook", që e pyet nëse është i gatshëm të përballet me kryeopozitarin Lulzim Basha në një ndeshje artesh marcialle. Por kryeministri thotë se Basha nuk pranon asnjë kontakt joteleviziv në një distancë prej 1 kilometër. Komentuesi: Rama, a je gati për një ndeshje UFC kundër Bashës. Rama: Si ndeshesh me ata që s'pranojnë asnjë kontakt joteleviziv në distancë nën 1 km? Unë jam gati sigurisht, gjithnjë.



Kryeministri indian Modi, lideri botëror më i ndjekur në "Instagram"

Kryeministri indian, Modi është lideri më i ndjekur në botë në rrjetin social "Instagram". Narendra Modi është kryeministri më i ndjekur në "Instagram", ku ka rreth 14.8 ndjekës. Në vendet e para renditen dhe presidenti i Indonezisë, Joko Uidodo, me 12.2 milionë ndjekës dhe presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump me 10 milionë. Papa Francesco është në vendin e katërt me 5.7 milionë ndjekës dhe pas sovranit të Vatikanit, me 4 milionë ndjekës është mbretëresha Reina e Jordanisë, presidenti turk Erdoan dhe profile të Shtëpisë së Bardhë. Në vendin e tetë është familja mbretërore e Britanisë së Madhe, ndërsa 10 vendet e para mbyllen me Mohamed bin Rashid, sovranin e Dubait dhe kryeministri rus Dimitri Medvedev. Mes evropianëve, pas familjes mbretërore britanike është presidenti francez Emanuel Makron dhe kancelarja gjermane Merkel me më pak se 1 milion ndjekës.



Sa të lumtur janë deputetët kur ikin në SHBA

Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim vijon të bojktojë jetën parlamentare, duke denoncuar situatën e krimit në vend dhe keqeverisjen e socialistëve. Por, ky vendim duket se ka të bëjë vetëm me jetën parlamentare brenda vendit, se kur vjen puna tek udhëtimet jashtë shtetit, ai nuk ka vlerë. Kështu ka ndodhur edhe me deputetin demokrat Gent Strazimiri dhe me deputetin e LSI-së, Përparim Spahium, të cilët pavaresisht vendimit për bojkotin e parlamentit, janë bërë pjesë së fundmi të një vizite zyrtare në Uashington, në SHBA për Forumin Vjetor të NATO-s, krahas kolegëve socialistë Mimi Kodheli dhe Xhemal Qefalia. E siç duket edhe nga fotot, të 4 deputetët të djathtë dhe të majtë duket qartë se nuk i mbajnë mëri aspak njëri-tjetrit, përkundrazi janë shumë të lumtur që ndodhen bashkë në SHBA. Natyrisht që për këtë ka ndikuar efekti SHBA.



Tirana në protestë, Korça ndez magjishëm dekorin e festave


Tirana zien nga protestat e shumta të banorëve të Unazës së Re dhe nga ajo e studentëve, Korça është zhytur në atmosferë festive. Në Ditën Kombëtare të Rinisë, qyteti i Korçës ka zgjedhur të ndezë dekorin e festave. Kryebashkiaku i Korçës, Sotirag Filo ka publikuar në profilin e tij në "Facebook" një foto nga atmosfera magjike që është krijuar në këtë qytet. "Një super atmosferë festive në Korçë. Ndezëm dekorin e festave me Festivalin e Dritave. Mos e humb atmosferën magjike, që vetëm një qytet si Korça ta dhuron", shkruan Filo.

Këshilla

“

Nëse mund t'u besohet studimeve, një në dhjetë persona të rritur flenë gjumë të mjaftueshëm e cilësor, ndërsa shumica nga ne mezi i mbajmë qepallat hapur. Cili është sekret i tyre?

”



Si t'i zgjidhni problemet e pagjumësisë dhe të lodhjes kronike

Shumica e njerëzve në kohën e sotme, të cilët kanë fatin të punojnë dhe të kenë të ardhura, nuk flenë sa duhet, kanë treguar disa studime. Sipas këtyre hulumtimeve, vetëm çdo i dhjeti person i hemisferës perëndimore fle sa duhet, ndërsa arsyt për këtë janë të shumta. Si t'i shmangim apo t'i largojmë gjithë ato gjëra që na e pengojnë gjumin dhe në fund të mësojmë të flemë shëndetshëm? Ju sjellim disa këshilla të mira.

PARA GJUMIT

Edhe pse për ndikimin e ushqimit që e konsumojmë para gjumit në peshën trupore ende diskutohet (disa pohojnë që i kontribuon trashësi, të tjerët pohojnë që nuk është ashtu), një gjë është e sigurt - ngrënia e tepërt para shkuarjes në shtrat me siguri nuk do t'i ndihmojë gjumit kualitativ. Mos hani vakte të bollshme të paktën tri orë para se të shkoni në shtrat, e nëse jeni shumë të uritur, hani diçka të shëndetshme, si karota të freskëta. Njëjtë kështu, nuk është nevoja aspak të shpenzohen fjalët për domosdoshmërinë e shmangies së pijeve të ëmbla energetike, si atyre me kafeinë. Gjithsesi shmangeni dhe alkoolin. Edhe pse konsumimi i tij do të ndihmojë të flini më lehtë, alkooli do të dehidrojë trupin tuaj dhe do të shkatërrojë seriozisht kualitetin e gjumit. Sigurohuni që hapësira në të cilën flini të jetë e ajrosur mirë para gjumit dhe sipas mundësisë pa ndonjë pajisje të ndezur elektronike. Po kështu, do të ishte ideale të flini në errësirë të plotë. Temperatura optimale e dhomës në të cilën flini nuk duhet të kalojë 16 gradë në dimër.

DISPONIMI I DUHUR

Arritja e gjendjes adekuatë të vetëdijes para gjumit është kyç për gjumin kualitativ. Largoni nga mendja të gjitha brengat që ju shqetësojnë dhe mos e lodhni veten me përpilimin e listës të obligimeve për ditën



e ardhshme pasi që jeni shtrirë, transmeton. Nëse nuk mundeni kursesi të relaksoheni, zgjatuni mirë dhe bëni një dush të ngrohtë në shoqëri të muzikës relaksuese. Shmangni ushtrimet para shkuarjes në shtrat, pasi që ato do t'ua shtojnë vigjilencën. Nëse nuk arrini

të flini, mos e ngarkoni veten me atë gjë - relaksohuni me leximin e librit të preferuar.

POZICIONI I TRUPIT DHE ZGJEDHJA E DYSHEKUT

Sipas hulumtimeve të përmendura më lart për kualitetin e gjumit, madje 40

për qind e personave të rritur kanë probleme me shpinën të shkaktuara nga përzgjedhja e keqe e dyshekut dhe jastekut si dhe pozita e keqe e trupit gjatë kohës së gjumit. Nëse keni supë të gjera dhe preferoni gjumin në ije apo në krah, zgjidhni jastëk të fortë dhe të përsh-

tashëm në aspektin anatomik, që qafa juaj të jetë në pozitën më të shëndetshme gjatë kohës së gjumit. Produktet nga shkuma apo sfungjeri memorik po ashtu janë ide e mirë, pasi që do t'i mundësojnë mbështetje sheshtë kokës suaj. Përfundimisht, dysheku i fortë ka rëndësi të jashtëzakonshme për gjumë të shëndetshëm nëse keni ndonjë kilogram të tepërt - fjetja në dyshek të butë mund t'ua lëndojë shpinën për kohë të gjatë. Pozita më e shëndetshme e fjetjes është ajo fetale. Duke fjetur në stomak krijohet presion në pjesën e poshtme të shpinës, që herët a vonë çon deri te dhimbja e sikletshme.

ÇARÇAFËT

Çarçafët janë pjesa të cilës nuk i kushtohet shumë kujdesi i njëjtë si dyshekëve dhe jastëkëve, por nuk janë fare më pak të rëndësishëm për gjumin kualitativ. Çarçafët me trashësinë, llojin, materialin dhe mënyrën se si janë punuar duhet t'i përshatën stinës aktuale. Nëse zgjoheni shpesh të djersitur gjatë natës, zgjidhni ata që reagojnë në temperaturën tuaj trupore. Të tillat janë zakonisht më shtrenjët, por janë investim i shkëlqyer për gjumë të mirë. Trupi ynë me djersitje mesatarisht humb edhe deri në gjysmë litri ujë gjatë natës, për ç'arsye është jashtëzakonisht e rëndësishme të flini në hapësirë me qarkullim të ajrit të freskët, veçanërisht nëse më shumë ju flitet në dhomë

me sipërfaqe më të vogël. Nëse flini edhe me dikë tjetër në shtratin e njëjtë, madhësia e dyshekut të jetë sa më e madhe që mundet, transmeton. Pavarësisht miteve urbane, dyshekët e mëdhenj do ta ndihmojnë kualitetin e gjumit të partnerit dhe juve, por nuk do ta vrasin romantikën. Në fund, mos harroni të paktën çdo dy javë të lani çarçafët në 60 shkallë për ta larguar problemën e merimangave dhe pluhurit.

ZGJIMI!

Zgimi çdo mëngjes në kohë të njëjtë është mënyrë e shkëlqyeshme të stabilizoni shprehitë tuaja të gjumit dhe bioritmin. Nëse flini shumë pak gjatë ditëve të punës, ndryshojeni orarin tuaj ditor, dhe mos tentoni ta kompensoni gjumin me qëndrimet shumë të gjata në shtrat gjatë vikendit, pasi që ato do ta çrregullojnë edhe më shumë. Nëse jeni një nga ata persona që kanë probleme me zgjimin, shfrytëzojeni më mirë alarmin duke e kurdisur orën ose telefonin kur duhet të ngriheni nga shtrati dhe jo thjesht të shtypni "snooze". Nëse është e mundur, menjëherë pas zgjimit ndizni radion ose lajmet në televizor që t'ju zgjohet edhe mendja. Dhe në fund, nëse jastë ka dritë të ditës, gjithsesi lëreni të depërtojë në dhomë e nëse nuk është e mundur, ndriçoni dhomën maksimalisht derisa të zgjoheni.

VITI I SKENDERBEUT



Fatos Qerimaj



Vaso Tole

TOLE, QERIMAJ E ZAGANJORI

Tri kompozime për Skënderbeun

Ministria e Kulturës organizon dhënien e çmimeve të "Konkursit Mbarëkombëtar të Krijimitarisë Muzikore" në zhanret e mëdha të muzikës skenike: opera, balet dhe muzikal. Konkursi u çel në kuadër të vitit 2018, shpallur nga qeveria shqiptare "Viti mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeut", në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambliit Popullor. Veprat dhe kompozitorët konkurrues do të mund të ndiqen në natën e ndarjes së çmimeve në 'ArTurbi-na' në datën 14 dhjetor - ora 19:00.

VASIL S. TOLE

Tole merr pjesë në konkurs në zhanrin e muzikës skenike. Vasil S. Tole - Opera Solemne - Skënderbeu Kryezoti i Arbrit me libret të Theofan Stilian Nollit dhe Vasil S. Tole. Tole diplomohet për kompozicion në Fakultetin e Muzikës, pranë Akademisë së Arteve, në Tiranë, më 1987, në klasën e prof. Kozma Larës. Mban titullin profesor dhe akademik pas një sërë studimesh dhe doktoraturash në fushën e etnomuzikologjisë: studime pasuniversitare në kompozicion pranë "Folkwang Hochschule", Essen-Gjermani, në klasën e prof. Wolfgang Hufschmidt si dhe studime pas doktoratës në Departamentin e Muzikologjisë pranë Universitetit të Athinës, Greqi. Karriera e tij kap një gamë të gjerë të një veprimtarie studimore dhe publicistike, me pjesëmarrje në shumë festivale, konferenca dhe tryeza për muzikën në Shqipëri dhe jashtë saj. Përfaqësues aktiv i brezit të ri të kompozitorëve shqiptarë, Vasil S. Tole është nisimtar i alternativave të reja krijuese dhe si një ndër mbartësit më të vendosur të konceptit të ristrukturimit të lëndës muzikore folklorike shqiptare, në dobi të gjetjes së identitetit dhe risive në

Dy balet e një opera për kyeherin, kompozitorët konkurrojnë në ministri



Jetmir Zaganjori

muzikën bashkëkohore. Fitues i disa çmimeve të rëndësishme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, fitues i çmimit të parë të kompozimit "Dimitris Mitropoulos", Athinë 2001, me operën "Eumenidet". Pas viteve '90 bëhet nisimtar i themelimit dhe drejtimit të disa organizmave të rëndësishme muzikore, si: ODEA, Akademi e Artit dhe Trashëgimisë. Karriera e tij shënon postin e drejtorit të Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit në Tiranë, si dhe ka mbajtur pozicionin e drejtorit të Trashëgimisë Kulturore në Ministrinë e Kulturës. Në vitin 2005, si ekspert i etnomuzikologjisë përgatiti dosjen e polifonisë me iso të Shqipërisë së Jugut, e cila u shpall nga UNESCO si "Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit".

JETMIR ZAGANJORI

Zaganjori merr pjesë në

e tjerë konkursi në natën e madhe të ndarjes së çmimeve në 'ArTurbi-na', në datën 14 dhjetor - ora 19:00.

FATOS QERIMAJ

Qerimaj merr pjesë në konkurs në zhanrin skenik të baletit me pjesën "Jehona e Skënderbeut" me libret të Petrit Rukës. Fatos Qerimaj vjen nga një familje muzikantësh të njohur shqiptarë, që kanë luajtur një rol pozitiv në kultivimin dhe

erhapjen e artit dhe kulturës ndiqni në natën e madhe të ndarjes së çmimeve në 'ArTurbi-na', në datën 14 dhjetor - ora 19:00. Qerimaj është diplomuar në klarinetë si dhe ka ndjekur studimet në kompozicion me profesor Česk Zadeja në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, Shqipëri në vitin 1982. Mban titullin profesor dhe aktualisht punon si pedagog në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë. Fatos Qerimaj ka një karrierë shumë të pasur artistike jo vetëm në koncerte solistike në klarinetë, por edhe si kompozitor. Ka realizuar disa koncerte solistike me orkestrat si Radio Televizioni Shqiptar dhe në Kroaci me Orkestrën Simfonike të Dubrovnikut. Fatos Qerimaj është themelues dhe dirigjent i dy grupeve muzikore në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë: orkestra "In-Sequence" dhe orkestra "Big Band. Qerimaj ka performuar në një numër të konsiderueshëm koncertesh jashtë Shqipërisë, si Greqia, Italia, Franca, Zvicra, Gjermania, Danimarka, Suedia, Austria, Serbia, Anglia, Kina dhe është një i ftuar i shpeshtë në Kroaci. Ka kompozuar disa vepra simfonike, balet dhe vepra të muzikës së dhomës dhe është fitues i disa çmimeve. Në vitin 1991 u nderua me çmimin "Tefta Tashko", "Vepra më e mirë e viti" për koncertin e tij fantazi për klarinetë dhe orkestrë simfonike. Në vitin 1995, ai fitoi çmimin për "Veprën më të mirë simfonike" të quajtur "Take Vango". Qerimaj është gjithashtu kompozitor i shumë kolonave zanore në kinematografi dhe teatër. Për virtuozeitetin e tij si klarinetist, ai u vlerësua si interpretuesi më i mirë i vitit 2005 në çmimet "Kult" 2005. Ai është drejtor artistik i disa festivaleve në Tiranë: Festivali i Xhazit, Festivali Clarimpro, Festivali Flauti Magjik, si dhe është anëtar i disa organizatave artistike në Shqipëri dhe jashtë saj.

“
Konkursi u çel në kuadër të vitit 2018, shpallur nga qeveria shqiptare “Viti mbarëkombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu”, në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambliit Popullor. Veprat dhe kompozitorët konkurrues do të mund të ndiqen në natën e ndarjes së çmimeve në ArTurbi-na në datën 14 dhjetor - ora 19:00.

FESTIVALI

Viktor Zhusti prezanton festivalin e RTSH, i ftuar Ermal Meta

Fatmira Nikolli

Inva Mula: Homazh për Gaço Çakon dhe Fatos Arapin, e ftuar edhe Erza Muqolli

Viktor Zhusti e prezantoi edhe para 47 vitesh: Rikthehem me emocion

Viktor Zhusti i rikthehet pas 47 vitesh prezantimit të Festivalit të Këngës në Radio Televizionin Shqiptar. Në konferencën për mediat, mbajtur të martën në Tiranë, ai kujtoi se herën e parë, në festivalin e 10-të ka qenë përkrah Edi Luarasi. "Mendova që pas 47 viteve të vish sërisht në skenën e festivalit është diçka e bukur. Një festival që nuk ka asnjë lidhje qoftë në organizim, qoftë në konceptim me atë të 47 viteve më parë, mu duk me shumë interes. Në festivalin e 10-të kam qenë bashkë me kolegen time Edi Luarasi. Edi Luarasi ishte një yll që kaloi në skenën shqiptare, këngëtare, aktore me një bukuri dhe inteligjencë të veçantë, së cilës në këtë rast megjithëse ka problem shëndetësore, i uroj të ketë sa më shumë shëndet, uroj të jetë gjithmonë mirë, sepse nga yll është shndërruar në një meteor që kaloi në qiellin shqiptar. Kur më thanë për festivalin e 57-të, u emocionova! Kur shikoj me kë duhet ta prezantoj u trondita!", tha ai.

Përkrah tij do të jetë Ana Golja, aktore, producente, këngëtare shqiptare në Kanada. Përveç prezantuesve, Festivali i 57-të në RTSH do ketë edhe elementë të tjerë, risi që nuk janë prezantuar dje. "Në fakt, surprizat nuk e bëjnë festivalin, festivalin e bën një krijimtari e bukur, një estetikë e bukur, një prezantim i bukur. Ky është thelbi", tha drejtorja artistike Inva Mula. Sipas saj, i ftuari është si qershia mbi tortë dhe me buxhetet tona që kanë pasur, janë kujdesur të ftojnë ata që përballohen. "Dëshirat mund të jenë të ndryshme. Ajo që mund të them për Ermal Metën si i ftuar i festivalit është se ai ka vendin më të bukur që historikisht mund t'ia krijonte situata. Vjen si fitues i Festivalit të Sanremo, që është festivali mitik e shembull i të gjitha festivaleve. Është hera e parë që në Festivalin tonë vjen një fitues..



Viktor Zhusti dhe Ana Golja

INVA MULA

Ajo që mund të them për Ermal Metën si i ftuar i festivalit është se ai ka vendin më të bukur që historikisht mund t'ia krijonte situata. Vjen si fitues i Festivalit të Sanremo, që është festivali mitik e shembull i të gjithë festivaleve. Është hera e parë që në Festivalin tonë vjen një fitues..

homazh në një festival si i RTSH-së, ku vlerat janë primaret. E ftuar tjetër do të jetë Erza Muqolli, artistja 12-vjeçare që ka bërë për vete gjithë publikun francez, si fituese e "France Got Talent".

Artistja Ana Golja tha dje para mediave se e njihte festivalin nga gjyshërit, që edhe në Kanada e ndjekin atë. "E kam shumë për nder që jam prezantuesja këtë vit dhe



Ervin Meta

falënderoj shumë Inva Mulën dhe RTSH-në, sepse u jam shumë mirënjohëse", tha Golja. Më tej, drejtori i festivalit, Martin Leka, sa i takon prezantueses së zgjedhur vlerësoi se: "Ka plot shqiptarë që edhe pse kanë lindur këtu, edhe pse kanë mbaruar një shkollë këtu, ikin jashtë dhe jo vetëm nuk dinë shqip, por edhe atë që e dinë e harrojnë. Dhe mësimi më i madh

që sjell Ana përveç artit të saj është që di një shqipë të shkëlqyer, e sigurisht kjo gjë është edhe meritë e prindërve të saj, ndaj Ana është një shembull për t'u ndjekur nga të gjithë ata që janë jashtë, apo që ikin jashtë dhe nuk marrin me vete thelbin e të qenit shqiptar, që është gjuha. Një ndër vlerat më të mëdha që sjell Ana është pikërisht ky mësim për gjithë shqiptarët".

KUSH ËSHTË ANA GOLJA

Ana është lindur në Toronto. Në moshën 5-vjeçare, Ana filloi të kërcente dhe dashuria e saj për të performuar u bë më e fortë ndërsa ajo rritej. Ajo filloi aktërimin në moshën 9-vjeçare dhe bëri audicionin e parë duke luajtur Lusën në "1-200 Missing". Më pas mori pjesë edhe në një sërë rolesh të tjera në filma dhe produksione të tjera televizive për rrjete të ndryshme televizive. Ana njihet më së shumti për rolin e saj në filmin "Full Out", një

dramë frymëzuese, e cila është transmetuar në NBC, kanalin familjar dhe tashmë po shfaqet edhe në "Netflix" në të gjithë botën. Ky rol e nominoi Anën për çmimin "Canadian Screen Award" në 2016-ën. Ana gjithashtu ka qenë pjesë e dramës "Degrassi" të nominuar për çmimet "Emmy", ku luante rolin e një dive problematike të quajtur "Zoe Rivas", i cili shfaqet në "Nick" dhe në "Netflix" kudo në botë. Kohët e fundit Golja vendosi të zgjeronte horizontin e saj duke marrë rolin e regjisores, po ashtu edhe atë të aktorese kryesore në filmin "The Cuban", shfaqur në krah të fituesit të çmimit "Oscar Lou Gosset Jr" dhe aktorese nominuar për "Oscar Shohreh Aghdashloo". Thuhet se ky film do të prezantohet në festivalin e filmit në 2019-ën. Më herët këtë vit Ana pati nderin të shfaqet në krah të aktorit të nominuar për çmimet "Oscar", John Travolta dhe Devon Sawa në filmin thriller "Moose", film i cili nuk e ka të përcaktuar ende datën e nxjerrjes në

ZHUSTI

Në festivalin e 10-të kam qenë bashkë me kolegen time Edi Luarasi. Edi Luarasi ishte një yll që kaloi në skenën shqiptare, këngëtare, aktore me një bukuri dhe inteligjencë të veçantë. Nga yll është shndërruar në një meteor që kaloi në qiellin shqiptar

kinema. Golja ka pasur nderin të performonte në disa prej skenave më prestigjioze dhe përpara kamerave, pasi punoi me Walter Bobbie në "White Christmas" dhe me Sir Andrew Lloyd Webber në "The Sound of Music". Ana kur nuk është e zënë duke performuar në skenë, është duke punuar me tekste këngësh dhe duke regjistruar muzikën e saj. Në shkurt të 2018-ës Ana nxori në treg albumin e saj të parë të titulluar "Epilogue" nën emrin e saj të vërtetë Muazana.

Pavarësisht axhendës së saj të zënë, Ana gjen kohë që të ndihmojë edhe komunitetin. Ajo bën shumë punë vullnetare, duke punuar me organizata të ndryshme bamirësie si "Free the Children" dhe duke mbajtur fjalime në "WE DAYS", rreth e rrotull Amerikës së Veriut.

Ajo dhe kasti i "Degrassi"-t udhëtojnë së bashku në Nikaragua dhe Ekuador ku ndihmuan në ndërtime dhe shkollave dhe sistemin e filtrimit të ujit.



Në natën e dytë të gjithë artistët konkurrentë do të kenë performanca, edhe vetë prezantuesja Ana Golja do të ketë një numër special. Në natën e tretë do të jenë dy homazhe dedikuar dy figurave të rëndësishme siç janë Gaço Çako dhe Fatos Arapi. Ajo që e bën më të veçantë se Mula, ka menduar të kujtojë ish-vjehrrin e saj, artistin e njohur Gaço Çako, duke i bërë

Opinion

i Ditës

PD-ja e sotme, ose e keqja jonë më e vogël...

Nga Xhevat Mustafa

(vijon nga faqja 1)

...me suksese e merita, me gabime e dështime, me maja të ngjitura dhe rrëshqitje pas, me ngecje dhe rrotullime në vend, me rrëzime të dhimbshme dhe ngritje entuziaste, me përvojë pozitive dhe negative, me vlerësime dhe kritika jo të pakta dhe përgjithësisht të sakta.

Tani pas 28 vjetësh, PD-ja duhet të ketë nostalgji për mbështetjen gati popullore, sidomos në dy vitet e parë dhe për kuotën e lartë të përqindjes së votave në zgjedhjet politike të 22 marsit 1992. Megjithatë, pavarësisht firove nga konsumimi i pashmangshëm gjatë 13 vjetëve në qeverisje dhe gjatë këtyre 5 vjetëve si gjasme opozitë, apo si një kopje e keqe e vetvetes; nga mungesa e "doganës" apo e "filtrave" ndaj prurjeve të reja për përtëritjen e saj, Partia Demokratike vazhdon të ketë, më shumë se sa meriton për çka përfaqëson dhe po bën këto vite, mbështetje të kënaqshme në elektoratin e vet, tashmë gjenetik apo tradicional si dhe në arenën ndërkombëtare.

Paradoksalisht, edhe pse ka mbi 5 vjet që de jure, nuk është më kryetar i PD-së, i vetëlarguar pa u merakosur shumë se në duart e cilëve po e linte, Berisha është politikani dhe pushtetari më agresiv ndaj të majtës dhe qeverive të saj, por edhe më i sulmuari me kritika dhe akuza, me shpifje dhe sharje, nga ana e së majtës. Prej kohësh, ai është regjuri dhe mësuar me to dhe prandaj i pret përgjithësisht me indiferentizëm dhe buzëqeshje, duke mos ndier dhe shpreh qejmbejtje të madhe nga zërat politikë, mediaticë dhe qytetarë se "të gjitha fajet i ka Saliu", edhe kur fajet dhe përgjegjësitë janë të të tjerëve. Ndoshta ka ardhur koha që nga e majta të cohët ndërmend edhe pyetja se mos i kanë rënë dhe vazhdojnë t'i bien padrejtësisht më qafë, se ndoshta gjatë mandateve qeverisës të Berishës nuk kanë humbur aq sa peshojnë ata, si shitësit e këqij, duke u ngrënë tepër në peshë blierëve... Aq më tepër që gjatë periudhës 22 mars 1992-1997, ai nuk i pengoi të vazhdonin të startonin shumë më parë dhe të fuqizoheshin shumë më tepër se të djathtët e paktë në rrugën e bizneseve. Po kështu, duke u zbatuar motoja e Berishës "Opozitarë, por vëllezër", edhe në sofrat e mëdha të tenderave dhe të korrupsionit, gjatë 13 vjetëve të Berishës, nën hundën e tij, biznesmenët socialistë kanë pasur plot vende të lira dhe kanë ngrënë me të dy duart. Qofsha i gabuar, por personalisht mendoj se nëse PD-ja është ndëshkuar aq rëndë në betejat zgjedhore të periudhës 2013-2017, nëse ka ardhur në këto ditë, kur nuk kuptohet se është "e gjallë apo e varrosur për së gjalli", fajet dhe përgjegjësitë më të shumta mund të kërkojnë dhe gjenden po tek



Berisha. Njëherazi, mund të shtrohen edhe të paktën katër pyetje në adresë të tij: Përse kaq shumë "gabime", kur thuhet se përgjithësisht njeriu i zgjuar gabon vetëm një herë në jetë? A mund të quhen dhe arkivohen si krejt të rastësishme, njerëzore, të paparandalueshme, kolektive? Përse futi në gjirin e PD-së aq shumë njerëz, që i njihte mirë se ishin ose krejt "mish i huaj" për të, ose kalorës për përfitime ngushtësisht individuale dhe familjare? Përse nuk parashikoi dhe shikoi se me korrupsionin e tyre të pafre, sidomos në mandatin e dytë, i jepej shkas e rast Edi Ramës dhe kuku llave të tij të përrallishtin dhe llomtosisin se "të dy palët janë njësoj", slogan që "vret" urgjencën dhe domosdoshmërinë e rrotacionit politik, edhe sikur të sjellë një qeverisje, qoftë edhe 10-20 për qind më të mirë se kjo e gjasme "rilindjes"? Në mënyrë figurative, falë gabimeve të shumta të Berishës, si rregull shoqëruar para apo prapa me merita jo të pakta e të pamohueshme, mund të thuhet se në fillimet e saj Berisha e ngriti PD-në në majtë të Korabit, por sidomos në mandatin e dytë 2009-2013, lejoi që ajo të gremisje në "fushën e Dibrës", duke thyer brinjë, kocka, kokë, deri aty sa sot e kësaj dite, edhe kur ka

shanse e raste të tregojë gjallesë e forcë, duket akoma ose si akoma në gjendje kome apo si e porsadalë nga gjendja e komës... Në këto kushte, disa demokratëve të vërtetë e të përjetshëm, themelues dhe të muajve të parë tepër të vështirë të jetës së saj, që kanë sakrifikuar më shumë se sa kanë përfituar prej saj, mund t'u shpërthejë nga zemrat edhe thirrja "Bijë, PD-ja e nënës, çfarë të të qajë më parë!"

Sot, pas 28 viteve të PD-së, për faj e përgjegjësi të saj e të PS-së dhe LSI-së, nuk mund të themi me zemër dhe bindje se sakrificat e djemve të Kavajës, Shkodrës, Tiranës dhe të të gjithë martirëve të demokracisë, të rënë apo të gjallë si dhe të shumicës së popullit kanë sjellë atë "Liri dhe Demokraci", që ëndërronin dhe dëshironin ata. Vërtetë u rrëzua diktatura komuniste dhe prej 26 vjetësh jetojmë me liri dhe demokraci të gjerë, por përsëri nuk mund të mburremi para tyre se e kemi bërë Shqipërinë, siç e dëshën ata, me shtet të fortë, me demokraci normalisht funksionale, me ekonomi moderne e të fuqishme, me paga, pensione dhe mirëqenie të lartë, të bollshme për t'i mbajtur në vend dhe pranë familjeve dhe jo për të emigruar

"...edhe tani, brenda 5 vjetëve dhe sidomos në mandatin e dytë qeverisës, e majta, e përfaqësuar aspak gjenetiksht dhe denjësisht nga gjasme "Rilindja", është bërë e keqja më e madhe për vendin dhe shumicën e popullit, për veprime dhe mosveprime skandaloze, për papërgjegjshmëri, pandryeshshmëri të saj dhe jo nga gurçikat apo ashklat e vëna nën rrota nga opozita apo "sozia" e saj, shumë e pangjashme dhe qesharake..."

mbitokësore, natyrore si dhe njerëzore, nga politikanë dhe qeveritarë të këtyre rreth 27 vjetëve të demokracisë shpreh menjëherë dhe ligësi, zbrazëti ideali, morali, përgjegjshmëri, ndjeshmëri njerëzore e sociale... Fakte të shumta, sidomos gjatë mandatit të dytë të qeverisjes nga "Rilindja" apo individualizuar nga Edi Rama me shokë e shoqe, me kulme disa koncesione flagrante, me falsifikimet dhe faturat e segmentit të autostradës së re tek "Astiri", apo rreth 1 miliard euro "shpërdorime" nga dikasteret qendrore dhe administrata, gjatë këtyre 10 muajve të vitit 2018, sipas KLSH-së, kanë lakuriqësuar jo vetëm papërgjegjshmërinë, pangopshëmërinë, paskrupullsinë e tyre për përfitime individuale. Këto kanë zbuluar dhe dëshmuar më shumë edhe genien e vendit pa opozitë të vërtetë, të singertë, të fuqishme, që mund t'i bëjë qeveritarët të mendohen mirë para se të hedhin firmat e të venë vultat për tendera dhe koncesione të tilla, që mbajnë era korrupsion dhe shpërdorime flagrante jo vetëm deri në Konispol, Vermosh e Morinë, por edhe deri në Bruksel, Berlin, Uashington... Por, nuk mund të përjashtohet kategorikisht, edhe që opozita e sotme po bën "spektorin" apo shoh me deklarata "çunash dhe goçash" për konkurse bukurie nga selitë e saj apo gjatë ditëve të enjte në parlament, joshur nga pjesa e vet në tepsinë mbushur jo me byrek, por me miliona, pallate, kulla, saraje... Në qershor 2013 shumica, kryesisht të majtë bënë zgjedhjen dhe zgjidhjen, që mund të vlerësohet dhe pranohet si e duhura dhe më e mira mes dy të këqijave... Atëherë qeverisja PD-LSI-PR, sidomos në mandatin e dytë dhe nën drejtimin e dyfishtë të Berishës, që bërë vërtetë e padurueshme dhe pakpërdishme, si e keqja më e madhe. Por, edhe tani, brenda 5 vjetëve dhe sidomos në fillim të mandatit të dytë qeverisës, e majta, e përfaqësuar aspak gjenetiksht dhe denjësisht nga gjasme "Rilindja" është bërë e keqja më e madhe për vendin dhe shumicën e popullit, për veprime dhe mosveprime skandaloze, për papërgjegjshmëri, pandryeshshmëri të saj dhe jo nga gurçikat apo ashklat e kërcitje e vënë nën rrota nga opozita apo "sozia" e saj, shumë e pangjashme dhe qesharake... Atëherë, duke mos e marrë si 100% të saktë se "të dyja palët janë njësoj", na mbetet që më 2019 dhe 2021, të zgjedhim të keqen më të vogël... Por, edhe që të mendojmë dhe luftojmë sinqerisht dhe me konsensus të gjerë qytetar, që të mos kemi rrotacione të këqijash, por forcash dhe koalicionesh politike, që mendojmë më shumë për vend e për popull se sa për vete, familje, për shokë e ortakë... Tejet e vështirë për një vend, popull dhe shoqëri me nivel të lartë mentaliteti komunisto-socialist, lindor, ballkanik, "fshataresk" dhe nivel të ulët edukate demokratike, por jo edhe krejt e

drejt vendeve të "Perëndimit Kapitalist" moshat e reja e për të mos lejuar gjëmën e katandisjes së vendit në më pak se 1 milion banorë pas disa dekadave. Ata kanë plot arsye të përjetojnë habi, zhgënjim, fyerje, revoltë, keqardhje... nga fakti që në qeverisjen aktuale janë në majtë të piramidës bij e bija, nipër dhe mbesa, dhëndurë e nuse të ish-nomenklaturës komuniste, konkretizuar edhe me praninë në poste të larta të Gramoz Ruçit e tj. Natyrisht, edhe kur tufa të veteraneve me portrete të Enver Hoxhës në duar festojnë siç dinë ata çdo 8, 17, 29 nëntor, pa e çuar ndërmend as të ndjehen faj, vrasin në ndërgjegje dhe as të shprehin pendesë e të kërkojnë falje për krimet monstruoze, që kanë kryer mbi bashkëkombës dhe bashkëqytetarë, me mendim dhe bindje "ndryshe", të "damkosur" dhe masakruar prej tyre me përrallat apo sajimet e trasha "armiç të partisë e të popullit", të "pushtetit popullor", të "diktaturës së proletariatit"... Pasardhësit apo trashëgimtarët e tyre kanë rrëmbyer në demokraci të gjitha pushtetet dhe janë të bashkuar e të vendosur t'i mbajnë fort, me mashtrim e demagogji, të kthyer në art e shkencë, me armë dhe me miliarda korrupsioni, kanabisi, krimi, pa ndier fare dhimbje e shqetësim për jetën mjerane dhe për varfërimin masiv e të pandalshëm të shumicës së qytetarëve... Nga ana tjetër, PD-ja dhe opozita në përgjithësi, po përjetojnë një rritje të tejzgjatur kukullëzimi, formaliteti apo informalliteti, duke mbetur shumë larg vetvetes dhe pritshmërive ndaj tyre. "Harresa", braktisja apo nëpërkëmbja e idealit dhe sakrificave të martirëve të demokracisë, e interesave jetike të shumicës së popullit, efektivitivi minimal i pasurive shumë të mëdha nën dhe

Opinioni *i* Ditës

Korrupsioni shqiptar po dridhet nga studentët

Nga Spartak Ngjela

(vijon nga faqja 1)

... që ai është në gjendje të vësh-tirësisë së tij psikike?

Sepse ai nuk e kupton dot forcën e shtresës shoqërore që është ng-ritur kundër tij. Ramës sot i është ngritur në protestë e ardhmja e Sh-qipërisë.

Studentët janë e ardhmja. Kjo është aksiomë.

Por, e ardhmja e Shqipërisë është kundër kryeministrit të paaftë, që studentët e dinë që është i lidhur edhe me korrupsionin.

Kjo është thirrja morale e së ardhmes dhe vetë e ardhmja është kundër kryeministrit Edi Rama.

Ky duhet të ikë. Nuk ka asnjë shpresë. Kur e ardhmja e kap nga gryka një kryeministër të paaftë e të korruptuar, ai nuk ka më asnjë shpresë.

Il. Si mund t'i flitet popullit që të ka zgjedhur si kryetari i një bande të armatosur?

Cili është halli i këtij kryemi-nistri - është pushteti që ky po humbet, apo degradimi i psikikes për të kaluar në një akt skizofrenik?

Po, nëse është pushteti i hum-bur, pse e do një pushtet që po varfëron dita-ditës shqiptarët?

Politikani që në një situatë si kjo nuk bën dot politikë me dorëheqje, po qëndron në kokëngjeshje, përfundon te bun-keri i Hitlerit.

Studentët në protestë të



përditshme janë e vetmja zgjidhje për shpëtimin e Shqipërisë nga qeverisjet e korrupsuara. Studentët e kanë kuptuar me arsye të shëndoshë se e gjithë kjo gjendje varfërie është rrjedhojë e qeverisjeve të korrupsuara që kanë drejtuar Shqipërinë, njëra pas tjetrës, në mbi 20 vjet. Pankartat që shpalosin studentët përditë tregojnë që ata e njohin mirë shkaku e varfërisë së tyre.

Kjo është arsyeja që studentët nuk do ta ndërpresin protestën e nisur.

III. Cfarë po kërkojnë studentët që nuk ua zbaton kjo qeveri e ky kryeministër?

Ata kanë tetë pika. Të tetë pikat janë të lidhura, dhe në këtë lidhje ato shkallmojnë korrupsionin e rektorateve dhe abuzimin me pseudoakademizmin banal që nuk jep dije.

Studentët dhe prindërit e tyre janë vjedhur.

Ata kërkojnë të ndalojnë vjedhjen.

Por, edhe qeveria bën të

njëjtën gjë, pse e ka lejuar ajo këtë gjendje abuzive?

Sepse është edhe vetë e tillë. Falsiteti akademik është i lidhur me falsitetin qeveritar: ky është thelbi i tetë pikave të studentëve. Prandaj ata janë vërtet e ardhmja morale e Sh-qipërisë dhe këtë e dinë tani të gjithë shqiptarët në Shqipëri dhe jashtë saj.

Korrupsioni shqiptar po dridhet. Studentët shqiptarë po i dalin zot Shqipërisë. Kjo është e vërteta absolute e kësaj kohe.

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

HOROSKOPI

DASHI

Shmangni debatet pa thelb. Zembrat mund të thyhen ose të fitohen, varësisht se sa mirë i luani letrat tuaja. Sot gjithçka ka të bëjë me cilësinë dhe veprimin. Përpjekjet do të japin rezultate jo të mira.

DEMI

Pavarësisht se ju duket se stuhia po del jashtë kontrollit, do të jeni në gjendje ta përballoni atë. Kini besim në natyrën tuaj. Sot është një ditë që do të shihni shpërblimet e veprimeve tuaja të zellshme.

BINJAKET

Jini gati për disa veprime, sepse jeni duke mbërritur një pikë kritike në ciklin tuaj emocional, kur zemra ndihet e rëndë. Duhet ndihma e një dore të fortë për t'ju çuar në një vend të sigurt.

GAFORJA

Në një varg dramash intensive emocionale, gjëja e fundit që ju duhet është një tjetër. Për fat të keq, duket se sot e tillë do të jetë dita. Një skenar i pabesueshëm romantik po ju afrohet.

LUANI

Ka shumë energji në shenjën tuaj. Çfarëdo që të ndodhë, mos lejoni që tëngjijtë të digjen. Vazhdoni të jeni luftëtar. Mos harroni se në fund të ditës ju duhet të jeni të kënaqur vetëm me punën tuaj.

VIRGJERESHA

Trajtojini me kujdes çështjet e ngutshme, sidomos kur është fjala për çështjet romantike dhe nevojat emocionale. Mos i injoroni ndjenjat tuaja në asnjë rrethanë. Ndiqni instinktet përpara se të besoni ndonjë gjë tjetër.

PESHORJA

Ndërsa përpigëni të shprehni mendimet tuaja sot, mund të keni ndjesinë se dikush po hedh "rërë" në fytyrën tuaj. Aftësia juaj për të nxjerrë jashtë lojë të tjerët do të jetë mjeti juaj më i fuqishëm.

AKREPI

Mbështetja dhe stabiliteti janë çelësat për të ruajtur një situatë të shëndetshme, sidomos kur bëhet fjalë për emocione gjithnjë të luhatshme. Disa çështje në lidhje me pronën ka të ngjarë të shfaqen në një mënyrë dramatike.

SHIGJETARI

Kjo parashikohet të jetë një ditë jashtëzakonisht sensuale, që ka gjasa të lëkundë emocionet tuaja. Mos u nxitoni! Do të jeni më mirë nëse tregoheni i rezervuar me vendimet tuaja.

BRICJAPI

Sot është dita juaj për të shkëlqyer në çdo mënyrë. Ka një përqendrim energjie në favorin tuaj, kështu që veprimi me guxim dhe pa hezitim. Është koha e duhur për ju që të ecni përpara.


UJORI

Zemra dhe emocionet tuaja janë në të njëjtën anë, por jo në anën që dëshironi. Shkak mund të jetë një ngjarje nga e kaluara. Përqendrohuni në të tashmen dhe lëreni pas të shkuarën.

PESHQIT

Keni aftësinë për të ruajtur qetësinë edhe në momente tensioni. Bëjeni edhe sot këtë, sepse gjasat janë që të përballeni me disa probleme në sektorin e punës. Kjo situatë do të jetë kalimtare.

PRAG PARTIZANI-SKËNDERBEU



Partizani-Kukësi është kryendeshja e javës së 17-të të Kategorisë Superiore, teksa kryeqytetasit kryesues do të presin verilindorët që ndajnë vendin e dytë me Skënderbeun në të njëjtën kuotë pikësh. Distanca mes të kuqve dhe Kukësit është 5 pikë, teksa suksesi i verilindorëve do t'i afronte me Partizanin, ndërsa nga ana tjetër, humbja do të sillte arratinë e kryeqytetasve. Gega dhe Cungu janë duke bërë

Gega pa Asanin, Cungu pa Dzarian

përgatitjet e radhës në prag të kryesfidës së të premtës, ndërsa të dy trajnerët kanë jo pak telashe. Gegësi i mungon një nga shtyllat kryesore të ekipit, Jasir Asani, që në takimin e fundit ndaj Teutës plotësoi numrin e kartonëve të verdhë. E njëjta situatë edhe për Cungun, që do të duhet të bëjë pa Dzarian,

me gjeorgjianin që, gjithashtu, plotësoi kartonët në përballjen ndaj Skënderbeut. Alternativat nuk mungojnë për të dy trajnerët. Gega mund të spositojnë Mensah në të djathtë e të aktivizojë Bardhin pas Hebajt, ndërsa Cungu mund të kryejë një rrokadë me Shkodrën, që luan pikërisht në atë pozicion.

TE PREMTEN		
Partizani - Kukësi	18:00	
TE SHUTUNEN		
Laçi - Tirana	14:00	
Flamurtari - Kamza	17:00	
TE DIELEN		
Kastrioti - Teuta	14:00	
Skënderbeu - Luftëtari	17:00	
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Partizani	16	35
Skënderbeu	16	30
Kukësi	16	30
Teuta	16	29
Laçi	16	26
Flamurtari	16	25
Tirana	16	14
Luftëtari	16	13
Kamza	16	12
Kastrioti	16	10

Liverpuli mposht Napolin në ndeshjen vendimtare dhe kalon në fazën e 1/8-ave bashkë me PSG-në



Jeton Selimi

Natë horror për Interin

Salah gol, Napoli eliminohet

PSV barazon 1-1 në "San Siro", kalon Totenhami

Grupi B i këtij sezoni në Champions League ka qenë pa diskutim një nga më të bukurit, për mënyrën sesi çështja e kualifikimit u diskutua deri në sekondat e fundit. Barcelona e kish të siguruar jo vetëm kualifikimin, por dhe vendin e parë në grup, prandaj kundër Totenhamit, luajti më shumë një ndeshje miqësore, ku provoi disa lojtarë të rinj. Nga ana tjetër, Totenhami kërkonte me doemos një rezultat pozitiv, që të ruante gjallë shpresat për një kualifikim të mundshëm dhe në momentet e fundit të sfidës, ia doli. Një gol i shënuar nga Dembele në minutën e 7 bëri që katalanasit të kalonin në avantazh, por Lukas Moura në të 85' i dha kualifikimit Totenhamit. Interit nuk i mjaftoi Ikardi për t'u kualifikuar, me sulmuesin argjentinas që shënoi golin e barazimit përballë PSV-së, në një sfidë ku kërkohet me patjetër fitorja. Kapiteni i zikaltërve ishte sërish protagonist për Interin, por pika e marrë përballë holandezëve, nuk mjaftoi që djemtë e Spaletit të kalonin në fazën me eliminim direkt.



Eliminohet edhe Napoli (9 pikë, +2), por të kuqtë kanë shënuar dy gola më shumë se napolitanët. Skuadra e drejtuar nga Ancelotti largohet kështu në mënyrë të dhimbshme nga Champions-i, duke u mjaftuar vetëm me "Europa League". Pavarësisht se

i kishin shanset për të mos dalë pa pikë nga "Anfield Road", djemtë e Klop e ruajtën mirë avantazhin e krijuar nga Salah që në pjesën e parë, duke u kualifikuar mes drithërimesh. PSG-ja e kishte të thjeshtë në transfertë kundër Cver-

na Zvezdës, duke fituar 3-1 dhe duke u kualifikuar si "kokë grupi". Kavani, Neymar dhe Markinjos shënuan për kryeqytetasit francezë. Grupi D i ka mbyllur llogaritë. Në një grup ku bëjnë pjesë Lokomotiva e Moskës, Schalke 04, Gallatasaraj dhe Porto, kanë qenë portugezët ata që e mbyllën në krye të grupit. Në vend të dytë, kualifikimin e siguruan dhe gjermanët Shalkes, të cilët kanë filluar të mendojnë për shortin e fazës me eliminim direkt. Ky grup pati interes vetëm të vendi i tretë, që siguron Europa League. Lokomotiva e Moskës dhe Gallatasaraj luftuan deri në sekondat e fundit për këtë vend, por në fund, ishin Turqi e Gallatës, që pavarësisht humbjes 2-3 kundër Portos, ruajtën vendin e tretë.

CHAMPIONS LEAGUE	
NDESHJET E FUNDIT	
TE MARTËN	
Grupi A	
Bryzh - Atletico Madrid	21:00
Monako - Borussia Dortmund	21:00
Grupi B	
Barcelona - Totenhem	21:00
Inter - PSV Eindhoven	21:00
Grupi C	
Crvena Zvezda - PSG	21:00
Liverpul - Napoli	21:00
Grupi D	
Gallatasaraj - Porto	18:55
Shalke - Lokomotiv Moska	21:00
TE MERKUREN	
Grupi E	
Ajaks - Bayern Mynih	21:00
Benfika - AEK Atinë	21:00
Grupi F	
Man. Siti - Hofenheim	21:00
Shakhtar Donjeck - Lions	21:00
Grupi G	
Real Madrid - CSKA Moskë	18:55
Viktoria Plzen - Roma	18:55
Grupi H	
Valencia - Man. Junajtid	21:00
Jang Bojs - Juventus	21:00

Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka do të jetë sërish në listën e kandidatëve për anëtarë të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s në Kongresin e 43-të që do të mbahet në Romë në datën 7 shkurt të vitit 2019. Lajmin e ka bërë publik vetë Duka, i cili nëpërmjet një postimi në faqen e "Facebook" shkruan: "Miq të e mi! Do të jem një nga kandidatët për anëtar të Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s. Shpresoj që në Kongresin e 43-të që do të mbahet në Romë në 7 shkurt 2019, të ketë sa më shumë federata mbështetëse. Kandidoj me dëshirën për të përfaqësuar

Dështoi në prillin e vitit të shkuar

Duka synon një vend në KE të UEFA-s, garon më 7 shkurt



futbollin shqiptar dhe interesat e federatave të vogla në or-

ganin më të lartë të futbollit Europian". Kjo do të jetë hera e dytë që presidenti Armand Duka do të kërkojë të hyjë në Komitetin Ekzekutiv të UEFA-s. Duka garoi dhe në prill të vitit 2017, por nuk arriti të zgjidhej mes 8 anëtarëve të KE-së, duke u renditur i nënti nga 11 pjesëmarrës që ishin në total.

SHORTI I U-21


UEFA ka hedhur dje shortin për pjesëmarrjen në Kampionatin Europian të U21 dhe sferat kanë qenë të pamëshirshme, pasi kanë vënë Shqipërinë në një grup mjaft të veçantë, ku rivale do të jetë edhe Kosova. Në shortin e hedhur dje në Nion të Zvicrës për edicionin 2021, fati nuk ka qenë aspak me kuqezinjët të cilët renditeshin në vazon e 5-të falë dështimeve në edicionin e fundit, ku grumbulloi shumë pak pikë. Nga vazo e parë ajo peshkoi Anglinë, skuadrën e dytë për nga koeficienti i vëzhgimit. Nga vazo e

Shqipëria e Kosova bashkë në një grup!

dytë doli emri i Austrisë, përsëri ekipi më i fortë i mundshëm nga kjo vazo, i cili ashtu si Anglia ka siguruar pjesëmarrjen në fazën finale të Europianit që zhvillohet në vitin e ardhshëm në San Marino. Edhe Turqia nga vazo e tretë nuk cilësohet kurrsesi një ekip i përballueshëm, pasi ka një brez të talentuar lojtarësh dhe me përfaqësueset e moshave bën gjithmonë mirë. Ndërkohë, nga vazo e katërt në grupin e Shqipërisë është vendosur Kosova, e cila donjëse kishte

marrë pjesë vetëm në një edicion të Europianit, renditje më lart se Shqipëria në vazo për shkak të rezultateve të mira që kishte siguruar. Ndërkohë, nga vazoja e fundit ka dalë emri i Andorrës, i vetmi rival me të cilin mund të thuhet me siguri të plotë që Shqipëria e përballon pa probleme në këtë grup i cili duket thuasht e pamundur për t'u kaluar pasi vendi i parë shkon direkt në Europian, ndërsa vendi i dytë shkon në play-off.

Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Një pikturë vetes.
 - Lindgren e Pippi çorapegjatës.
 - Thirre edhe kështu Persefoni.
 - Hapin ekspozitën.
 - Ruhet pa çifte.
 - Shiroka aktor.
 - Fillojnë masat.
 - Të parat në aksion.
 - Është gara më e gjatë.
 - Inicialet Pacino-s.
 - Janë sponsor të Tiranës.
 - Pavone këngëtare.
 - Kështu thirrej Marco Pantani.
 - Dieta pa ekstreme.
 - Janë sallat për projektione.
 - Duhet çarë më dritë.
 - Italia në tabelat.
 - Janë katrorë në sipërfaqe.
 - Williams tenisiste.
 - Në fillim të verës.
 - Cocker këngëtar.

- Të fundit në tender.
- Janë fletë trëndafili.
- Fillojnë ideologjinë.
- Është krahinë e Athinës.
- Emri i Zola.
- Hari spjune.
- Janë kulla në xhami.


- VERTIKAL**
- Njësi matëse për kondensator.
 - Artet pa re.
 - Fillojnë uraganin.
 - Nisin titrimin.
 - Janë në modë.
 - Inicialet e Kokoschka-s.
 - Një mund të jetë ekspres.
 - Mund të jenë ushtarake.
 - Jepen për hartim.
 - Janë të lira për hartim.
 - Është magjik ai i fatave.
 - Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
 - Një orgaizmatë humanitare.
 - Janë shkurre.
 - Janë kapo kozakë.
 - Nino kompozitor.
 - Fillojnë teorinë.
 - Kryqyteti i asirëve.
 - Një verë në Paris.
 - Një vepër si romani.
 - Mbyllin një sherr.
 - Kompozoi një Bolero.
 - Pak mbeturina.
 - Një bëhet për të mirë.
 - Është dhomë.
 - Peter që humb hijen.
 - Një pjesë e territorit.
 - Pak amerikanë.
 - Gjysmë litari.
 - Dy asa.
 - Kalimi në kufij.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
- Mondrian piktor.
 - Safin tenist.
 - Është e re pas Krishtit.
 - Janë grimca të famles së adroneve të tilla.
 - Fillojnë matematikën.
 - Mbarojnë fare.
 - Josa trainer.
 - Në mes të dhomës.
 - Gjysma e inatit.
 - Ishin shkolla edukimi.
 - Janë ritransmetues televizivë.
 - Ishte djali që vrau Odiseun.
 - Një pjesë e opozitës.
 - Një ekspres në binarë.
 - Kujt ia mbajnë... e mbështesin.
 - Mund të lakohen.
 - Një yll me bisht.
 - Italia në Internet.

- Edouard piktor.
- Shahu i fundit.
- Gjysma e aortës.
- Efekt... i François Truffaut.
- Inicialet e Lendl.
- Kufizojnë një kënd.
- Polanski regjisor.
- Skuadër greke.
- Brita e Arkimedit.
- Egoyan regjisor.
- Fillojnë turnin.


- VERTIKAL**
- Ishte shkolla e Arkimedit.
 - Grandi këngëtare.
 - Diftong teatral.
 - I përkasin stinës së nxehtë.
 - Një shishe bombë.
 - Janë në qendër.
 - Ndiqet nga një mi.
 - Janë këngëtarë lirikë.
 - Emër burri.
 - Një personazh i interpretuar nga Woody Allen.
 - Botom pa ekstreme.
 - Është figurë letrare.
 - Është enë kryesore gjaku.
 - Një pikë në ligj.
 - Risja pa kufij.
 - Ulen në Dhomën e lartë të tillë.
 - Janë fletë trëndafili.
 - Robert Mitchum.
 - Inicialet e Moravia-s.
 - Është si fatë.
 - Gjysma e ketrit.
 - Carolina e belle epoque.
 - U shkrua nga Zola.
 - Me të bëhet trokë.
 - Duken të parat.
 - Maten të parat.
 - Të parat në kufij.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRÇJIGJET E FJALËKRYQIJE TË NUMRIT TË KALUAR

A M O K A K F E S T A T
 F A R U K S H Q Y T A R I
 T L V A I E S A N A M
 A V E N D O S M E R T A
 M E R C E N A R E T R G
 P A R T E N O P E A F E J
 K O B A L T E R L A N A
 R A A I T U N E L E T
 M E L R A T T O J A E
 A T E L I E R L L A N O S
 R I T I I D A G R I
 S P O R T I S T E P A R A

FJALËKRYQI (1)

K U P A D A S M A T
 R R T K S I R T A K I
 P E R I U D H A T K I M
 D I M E N S I O N E T L A
 S I N T A K S A O I L
 T E T O R T L T R A
 Z A R A R E A S I R E T
 A R A E T I K E T A
 N D S T K O R J A O
 A L A T R A V T A O
 T A L B O T A A A T
 I D E A K Y G S T U F A

SUDOKU

3	5	1		7				9
	9	7	4	8				
		8		5	1		3	
	1		7	2			4	3
9							5	8
	7	3		4	2			
4			2					
				7				4
		5	3	9		6	1	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	9	2	5	7	8	4	6	3
4	7	3	9	6	1	5	8	2
6	5	8	2	3	4	1	7	9
3	1	4	6	8	2	7	9	5
7	6	5	1	9	3	2	4	8
2	8	9	7	4	5	3	1	6
5	2	6	8	1	7	9	3	4
9	4	7	3	5	6	8	2	1
8	3	1	4	2	9	6	5	7

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

-Mënyra më e sigurtë për të shkatërruar një të ri është ti mësosh atij të vlerësojë më shumë ata që mendojnë si ai, sesa ata që mendojnë ndryshe nga ai.

-"Ndonjëherë unë zhytem aq shumë të vetja, sa që ndodh që të takoj dikë në rrugë dhe e humb, kam nevojë për kohë për t'u përshtatur me realitetin".

-Njerëzit ndryshojnë për dy arsye...Ose mësojnë shumë dhe duan të ndryshojnë, ose janë lënduar shumë dhe duhet të ndryshojnë.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

7	15	3	6		4	6		6	1	4	1	7	T	R	A	P	A	E	F	I	K	A	S							
1	15			11	8		8	6		5	L	3	I	6	M	1	A	H	E	R	O	I	Z	M	I	P	A	K	O	
17			14	8	5	8	12	1	7	8	7		5	E	K	T	P	A	P	A	T	L								
	6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8	S	P	E	R	A	N	D	O	R	I	A							
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7		13		T	E	R	E	N	C	E	H	I	L	L						
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7		7	7	D	E	T	E	K	T	I	V	I	E	K	S						
6		13	3	8	13	9				12	1	7	A	N	E	U	A	N	M	A	T	I	A							
16		4	13	13	3		6	1	5	5	3		M	O	R	R	I	P	I	M	Z									
1	6	3	1	13	7		17			9	4	8	A	R	R	I	E	A	H	I	E									
13		9	7	8	17	3	16	9	15	8			A	R	E	A	L	S	E	L	L	E	R	S						
3	7	13		8	7	3	5	8	13	3		8	E	C	A	R	A	M	A	N	E	T	I							
1	5	3	11	3		4	3	15	7	1	17	3	T	R	A	K	T	I	A	A	Z	I	L							

- "Unë jam një skllav i papënduar, i nënshtruar ndaj penës dhe bojës".
- "Guximi para rezikut, është gjysma e fitores"
- Nuk ka bisedë më interesante mes të dashuruarve, kur të dy heshtin.
- "Kur dy njerëz flasin dhe njëri papritur zemërohet, ai që braktis bisedën është i mëncur..."

Thënie të mëncura

